



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Mami ”**

ofruar nga

“Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Zamira Shabani

2. Phd. Blerina Duka

Qershor/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Mami” ofruar nga “Fakulteti i
Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Mjekësisë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; Departamenti i Lëndëve Paraklinike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Mami”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 23, datë 14.01.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 51, datë 06.02.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE/ 5PAK v.a. 2022-2023 7 PAE/ 5PAK v.a. 2021-2022 7 PAE/ 5PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	2020-2021 janë 18 studentë
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-13 123

Web site: www.asc.al

Email: info@ascal.al




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar në vitin 2013 me VKM Nr. 48, datë 23.01.2013. Fillesat e edukimit universitar në vend në fushën e mjekësisë nisin me themelimin e Institutit të Lartë Mjekësor (ILM) në 22 shtator të vitit 1952 me detyrë të tij përgatitjen e Mjekëve të Përgjithshëm. Në vitin 1957 u vendos krijimi i Universitetit të Tiranës, mbi bazën e disa instituteve të larta, ku përfshihej dhe Instituti i Lartë Mjekësor, i cili u shndërrua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Në vitin 1994 u themelua Shkolla e Lartë e Infermierisë e cila në vitin 2004 u shndërrua në Fakultetin e Infermierisë, në varësi të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Që nga viti 2016, pas riorganizimit institucional, UMT përbëhet nga tri fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare. Aktualisht në strukturën akademike të UMT përfshihen, 3 fakultete, 22 departamente, 72 shërbime shëndetësore (me funksion diagnostikues-trajtues dhe mësimor, kërkimor shkencor.

Programi i studimit Master Profesional në “Mami” i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT), Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT) është hapur si programi studimi Diplomë e Nivelit të Dytë me VKM Nr.1184, datë 3.12.2009. Programi i studimit është hartuar si një program studimi i ciklit të dytë MP në përputhje me Sistemin europian të transferimit të krediteve dhe Ligjin për IAL.

Programi Master Profesional në Mami, ofrohet në nivel njësie kryesore dhe përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është vetë fakulteti ndërsa njësitë bazë dhe strukturat e tjera japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit.

Programi zhvillohet në bazë të parimeve të lirisë akademike, autonomisë institucionale, cilësisë, efektshmërisë dhe vetëfinancimit. Programi i studimit MP në “Mami” është krijuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik institucional.

Ky program studimi ka si qëllim formimin teoriko-profesional të profesionistëve të ardhshëm në fushën e mamisë, të aftë për t’u përshtatur me nevojat e tregut të punës si dhe krijimin e mundësive për ekuivalentimin e diplomës në tregun ndërkombëtar.



3



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është një dokument i përpiluar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit Master Profesional në Mami, i cili ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike pranë Universitetit të Mjekësisë Tiranë. Ky raport përmbledh të gjitha hapat e ndjekura për realizimin e këtij procesi bazuar në rregulloren përkatëse të ASCAL.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i shprehur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në këtë institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejtë e në mënyrë objektive performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht;

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin gupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. As. Dr. Zamira Shabani dhe Dr. Blerina Duka. Koordinator Teknik i ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Muhamed Prezja. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në FSHMT/UMT është zhvilluar në datat 18-19 Mars 2024. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.



Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga FSHMT dhe UMT në ofrimin e një programi të mirë të MP në "Mami". Gjithashtu, jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratat e ardhshme të mamive.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit MP në "Mami" nga ana e FSHMT.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënie të informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Institucioni shprehu dakordësinë me draft raportin dhe nuk ka komente për raportin final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Mami”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar në vitin 2013 me VKM Nr. 48, datë 23.01.2013. Që nga viti 2016, pas riorganizimit institucional, UMT përbëhet nga tri fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare. Programi i studimit Master Profesional në “Mami” i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT), Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT) është hapur si programi studimi Diplomë e Nivelit të Dytë me VKM Nr.1184, datë 3.12.2009. Programi i studimit është hartuar si një program studimi i ciklit të dytë MP në përputhje me Sistemin europian të transferimit të krediteve dhe Ligjin për IAL. Programi është riorganizuar në vitin 2018 në përputhje me ligjin 80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Programi Master Profesional në Mami nuk bie ndesh me interesat kombëtare. UMT vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni i UMT (Statuti i UMT, neni 4) synon arsimimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme në fushën e mjekësisë dhe ka për qëllim zhvillimin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë. Evidenca: - <i>Evidenca I Statuti i UMT.</i> - <i>Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe	FSHMT në përmbushje të misionit dhe vizionit të tij dhe njëkohësisht aktivitetit të gjithanshëm në fushën e shkencave mjekësore teknike, ka organizuar një program studimi i cili plotëson

misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	të gjithë spektrin e nevojave që kanë qendrat spitalore, shëndetësore publike e private në vend duke përfshirë në to personel të specializuar në fushën e mamisë. Studentët kanë mundësi të diplomohen në të tre ciklet e studimit që aktualisht fakulteti mbulon si bachelor, master profesional, master i shkencave në Mami dhe doktoraturë. Një nga objektivat kryesore të UMT është mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënia me në qendër formimin e studentëve. Kjo arrihet përmes formimit të specialistëve në fushën e shëndetësisë. Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë e Institucionit. Kjo pikë përmendet edhe në Rregulloren e programit të studimit (neni 3). Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 2 Rregullore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 4. Kërkesa _akreditim_ FSHMT 03.02.2023 - Evidenca 5. Rregullore FSHMT - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit MP “Mami” - Evidenca 170. Plan i Strategjik i Zhvillimit të UMT-së 2021-2024.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Strategjia e UMT ka disa objektiva specifike të cilat fokusohen tek organizimi institucional, mësimdhënia, kërkimi shkencor, sigurimi i brendshëm i cilësisë, veprimtaritë shërbyese si dhe marrëdhëniet me jashtë/ndërkombëtarizimi. Programi i studimit Master Profesional në “Mami” ofrohet në përputhje me këtë strategji. Programi i studimit orientohet drejt krijimit, zhvillimit, e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t’u bërë ekspertë të denjë të fushës së mamisë. Përmbajtja e programit, është hartuar, përditësuar dhe përshtatur nevojave që ka vendi por njëkohësisht ka reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e mamisë. Programi dhe personeli akademik i fakultetit kanë meritë në zhvillimin e programeve të mamisë në vend ku angazhimi ka qënë në forma të ndryshme asistuese, vlerësuese dhe ekspertize. Një tjetër kontribut i rëndësishëm i këtij programi dhe fakulteti është rritja e nivelit të shërbimeve në të gjitha qendrat e Obstetrike - Gjinekologjise në vend ku stafi kryesor i tyre është diplomuar nga FSHMT.




	Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 2 Rregullore e UMY; - Evidenca 5. Rregullore FSHMT - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit MP "Mami" - Evidenca 120. Te dhena per Alumni nga Udherat profesionale - Evidenca 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka sot 3 njësi kryesore nga të cilat ofrohen 94 programe studimi nga niveli i parë deri në ato të nivelit të tretë. UMT është një universitet i specializuar vetëm në fushën e mjekësisë. UMT është jo vetëm institucioni i vetëm në vend në fushën e mjekësisë por ai ka përgjegjësinë për krijimin e brezave të profesionistëve për të garantuar vijueshmërinë e shërbimeve mjekësore për vendin dhe me cilësi. Programet e studimit në UMT përfshirë këtu edhe këtë program studimi, synojnë transmetimin e njohurive në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare. Programi është në përputhje me vizionin, si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi studimi. Studimet në programin MP Mami, synojnë të sigurojnë njohuritë e nevojshme që kanë të diplomuarit në fushën e Mamisë, pasi përmbajtja e programit i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit MP "Mami" - Evidenca 55. Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT. - Evidenca 86; 86.1; 86.2 Programi MAMI - Evidenca 170. Plani Strategjik i Zhvillimit të UMT-së 2021-2024.
Konkluzione	Programet e studimit që ofrohen nga UMT nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit MP në "Mami" është hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. UMT ka si mision të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e vet si dhe të ofrojë programe studimi në të tre ciklet e studimit. MP në "Mami" ofrohet në përputhje me strategjinë e UMT.





	<i>Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada dhe kjo është një pikë e fortë e FSHMT. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njesisë Bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njesisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UMT u krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957. Universiteti është i akredituar më 21. 09. 2017, me VBA nr. 69. Stafi akademik i Departamentit DLKIPISBP: - për vitin akademik 2020-2021 për programin Master i shkencave në "Mami" ishte 22 PAE (1 Prof. Dr., 3 Prof. As., 16 Dr., 2 Msc) dhe 141 PAK (7 Prof. As., 23 Dr., 89 Msc, 12 Mp, 10 Bsc) dhe 3 personel ndihmës; - për vitin akademik 2021-2022 për programin Master i shkencave në "Mami" ishte 22 PAE (2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 13 Dr., 2 Msc) dhe 142 PAK (8 Prof. As., 24 Dr., 87 Msc, 13 Mp, 10 Bsc) dhe 3 personel ndihmës; - për vitin akademik 2022-2023 për programin Master i shkencave në "Mami" ishte 22 PAE (2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 13 Dr., 2 Msc) dhe 135 PAK (3 Prof. As., 21 Dr., 94 Msc, 10 Mp, 7 Bsc) dhe 3 personel ndihmës. FSHMT ndodhet në zemër të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", cka e bën atë fakultetin me aksesin më të shpejtë në mjedisin klinik për stafin dhe studentin. Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada dhe kjo është një pikë e fortë e FSHMT.

	Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, takimet në institucion dhe vizitës në laboratorët përkatëse, GVJ konstaton se institucioni ka përvojën e duhur në ofrimin e këtij programi studimi. Pozicionimi i FSHMT në ambientet e QSUNT i jep një prioritet të jashtëzakonshëm për sa i përket faciliteteve të krijuara për praktikën e studentëve. Evidencat: - Evidenca 8 Historiku i FSHMT - Evidenca 77 Vendim për Akreditimin Inst. të UMT - Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP - Evidenca 80; 81; 82 Raporti vjetor i FSHMT - Evidenca 97 Tabela përmbledhëse - Evidenca 1 17. Lista e laboratoreve didaktike në te 3 Fakultetet - Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mesimdhënis - Evidenca 119. Lista e aseteve infrastrukturore të UMT - Evidenca 165. Te dhëna statistikore _stafi akademik 2019-2024. - Evidenca 97.2 Tabela me statistikat përmbledhëse Ascal Mami.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Bazuar në statutin e institucionit, Rregulloren e universitetit, Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të UMT. Programi i studimit Master Profesional në “Mami” ofrohet nga DLKIPISBP, e mbulohet edhe nga dy departamente të tjera, Departamenti i Lëndëve Paraklinike (DLP) & Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë - Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ), në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njësisë Bazë. Këto tre Njësi bazë ofrojnë po ashtu programe studimi: - Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laboratorie dhe në Logopedi;

	- Master Profesional në Menaxhim infermieror, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator, në Logopedi, në Kujde Paliativ dhe në Infermieri Familje; - Master i Shkencave në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator dhe në Logopedi; - Doktoraturë në "Shkenca Mjekësore Teknike" me nënfusha (Fizioterapi dhe Rehabilitim; Infermieri dhe Mami; Teknologji mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese). Institucioni zbaton me përpikmëri çdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar. Programi i përket nivelit 7 të EQAF ose KSHK (Korniza Shqiptare e Kualifikimeve) Evidencat: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 2 Rregullore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP - Evidenca 169 RVB Institucional UMT - Evidenca 55.1. Lista e kodeve të programeve FSHMT. - Evidenca 170. Plan Strategjik i Zhvillimi të UMT-së 2021-2024.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit MP në "Mami" ofrohet nga DLKIPISBP, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. Ky nuk është një program ndërdisiplinor. Siç jemi shprehur edhe më sipër, UMT është një universitet i specializuar vetëm në fushën e mjekësisë dhe ky program studimi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njësies Bazë. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i UAM; - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit MP në "Mami"
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Ky nuk është një Master i cili ofrohet jashtë profilit të Institucionit

Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

Studentëve u jepet informacion për mundësitë e punësimit në fazën e pranimit dhe në përfundim të programeve të studimit, pas diplomimit. Studentëve u ofrohet shërbimi falas këshillimi për karrierë që i ndihmon ata të lokalizohen dhe të transferohen lehtësisht në tregun e punës. Zyra e Karrierës dhe Alumni (Të diplomuarit) pranë FSHMT ka një listë të studentëve të diplomuar të regjistruar nëpërmjet projektit të zbatuar, GRADUA. Në këtë mënyrë pas diplomimit ata kontaktohen për evente që zhvillon fakulteti ose universiteti në bashkëpunim me partnerët.

Për më tepër, UMT vazhdimisht organizon ëorkshop/trajnime, programe me qëllim edukimin në vazhdim. Gjithashtu UMT ka bashkëpunime me institucione të tjera dhe IAL për rritjen e cilësisë së mësimdhënies së studentëve që janë diplomuar pranë këtij fakulteti, madje angazhohet dhe për ecurinë e tyre pas diplomimit.

Evidencat:

- Evidenca 44. Lista e projekteve nderkombetare te aplikuar dhe te fituara.
- Evidenca 44.1.Projekte nderkombetare te fituara.
- Evidenca 45. Lista e projekteve kombetare te aplikuar dhe te fituara.
- Evidenca 46. Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS.
- Evidenca 47. Shembull Marreveshje per diploma te perbashketa Univ.Bologna.
- Evidenca 48. Shembull marreveshje bashkepunimi me IAL nderkombetare.
- Evidenca 55 Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT
- Evidenca 15 Aktivitete studente knonfere e shkencave mjekesore
- Evidenca 18. Konferenca vjetore FSHMT
- Evidenca 18.1 Konferenca Vjetore DLKIPISBP Dhjetor 2022
- Evidenca 29.Konferenca në Vlorë
- Evidenca 30.Konferenca-vjetore 2023 FSHMT- UISH
- Evidenca 124 Aktivitetet e këshillit studentor
- Evidenca 107.Manuali i keshillimit te karrieres fshmt.
- Evidenca 108.Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.
- Evidenca 108.1.Raport Aktiviteti i zyres se karrieres.

Konkluzione	<i>FSHMT me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ ka kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit në përputhje me Kodin dhe standartet e cilësisë</i> <i>Bazuar në statutin e institucionit, rregulloren e universitetit, Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të UMT. Programi i studimit, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore. Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti e Shkencave Mjekësore Teknike në të cilin ofrohen gjithë programet e tjerat teknike sikurse në çdo njësi të njëjtë në vend dhe Europë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UMT ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. UMT është pjesë integrale e politikave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku nëpërmjet akteve vendimmarrëse, UMT drejton dhe koordinon veprimtari në fushën e shëndetësisë, kërkimit, projekteve etj. Në këtë mënyrë, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Me qëllim ofrimin e këtij programi studimi, Njësitë bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i UMT - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP

	- Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit MP në "Mami"; - Evidenca 172 Rregullore e funksionimit Këshillit të Etikës UMT - Evidenca 173 Rregullore për përdorimin e postës elektronike - Evidenca 174 Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në UMT - Evidenca 175 Rregullore për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në UMT - Evidenca 176 Rregullore për fitimin e titujve akademike UMT - Evidenca 179 Rregullore për hartimin, zbatimin, menaxhimin e Projekteve UMT - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mesimore-shkencore UMT - Evidenca 183 Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik - Evidenca 184 Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë - Evidenca 112. Liste e Sherbimeve të QSU. - Evidenca 114. Bibliotekat online - lista dhe pershkrim.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Me qëllim formimin e studentëve, Qendrat Spitalore Universitare në vëndin tonë janë në dispozicion të studentëve të UMT, ku ata formohen sidomos në funksion të praktikës profesionale (kryesisht ato të Obstetrikë-Gjinekologjisë). Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, u informuam se janë 85 mbikqyrës së praktikës profesionale që ndjekin studentët në terren. Gjithashtu UMT raporton 10 marrëveshje bashkëpunimi Erasmus me Institucione jashtë Shqipërisë. Evidenca: - Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare; - Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera; - Evidenca 44 Lista e projekteve nderkombetare të aplikuara dhe të fituara; - Evidenca 44.1 Projekte nderkombetare të fituara

	- Evidenca 39.1 Pjesmarrje stafi ne aktivitete Erasmus - Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP; - Evidenca 80; 81; 82 Raporti vjetor i FSHMT - Evidenca 79; 70.1 Raport Vjetor Institucional; - Evidenca 97 Tabela përmbledhëse
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale, Fakultetit ka bashkëpunime të ngushta me institucione të arsimit të lartë si: QSUT, SUT, S.U.O.GJ "Mbretëresha Geraldinë", S.U.O.Gj "Koço Glozheni" Tiranë, struktura partnere për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës ku stafi i këtyre institucioneve është rekrutuar për mbikëqyrjen e praktikave apo stazhit si dhe trajnime të ndryshme etj. FSHMT gjithashtu ka zhvilluar një sërë aktiviteteve shkencore brenda institucionit dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera sipas referencave përkatëse. Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet në ambientet e Qendrave Spitalore Universitare të rregulluara me VKM. UMT ofron mundësitë më të mira për zhvillimin e praktikave profesionale. Gjithashtu ka dhe marrëveshje të shumta me shumë kompani, organizata dhe universitete të tjera. Evidencat: - Evidenca 47. Shembull Marrëveshje për diploma të përbashkëta-Univ.Bologna. - Evidenca 48. Shembull marrëveshje bashkëpunimi me IAL ndërkombetare. - Evidenca 49. Lista e bashkëpunimeve me IAL kombetare, ndërkombetare dhe institucione të tjera - Evidenca 112. Liste e Sherbimeve të QSUT - Evidenca 80. Raport vjetor FSHMT 2020-2021. - Evidenca 81. Raport vjetor FSHMT 2021-2022. - Evidenca 82. Raporti vjetor FSHMT 2023. - Evidenca 10. Revista shkencore FSHMT 2022, 2023 - Evidenca 15. Aktivitete libri i abstrakteve konferenca e shkencave mjekësore. - Evidenca 16. Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencorë dedikuar studentëve. FSHMT. - Evidenca 18. Konferenca vjetore libri i abstrakteve FSHMT. - Evidenca 19. Aktiviteti dt 14 Nëntor 2023 në FSHMT.

	- Evidenca 29. Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27. - Evidenca 30.Konferenca vjetore 2023 FSHMT ne bashkepunim me UV dhe UISH. - Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shendetesore universitare; - Evidenca 13.1; 13.2; 13.3 Ditar i praktike - Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP; - Evidenca 80; 81; 82 Raporti vjetor i FSHMT
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	UMT ka nënshkruar një numër të madh marrëveshesh të reja me institucione brenda dhe jashtë vendit. Qëllimi i kësaj është marrëveshje promovimi e bashkëpunimi në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Ndërkohë bashkëpunimi me partnerët e përhershëm si Urdhri i Infermierit, Shoqata Kombëtare e Profesionistëve Shqiptarë që kontribuojnë në organizimin e aktivitetit të përvitshëm të UMT në kuadër të realizimit të programit të studimit. Çdo vit akademik, UMT dhe njësitë bazë kryejnë analizën e punës dhe rezultatet e bashkëpunimit një pjesë e të cilave janë bërë publike në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit. Zhvillimi i bashkëpunimeve të reja, është pjesë e strategjisë së zhvillimit të UMT dhe FSHMT, proces i cili kryhet dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme. Evidencat: - Evidenca 47.Shembull Marreveshje per diploma te perbashketa-Univ.Bologna. - Evidenca 48. Shembull marreveshje bashkepunimi me IAL nderkombetare. - Evidenca 49.Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera - Evidenca 112.Liste e Sherbimeve te QSUT - Evidenca 144.VKM Për miratimin e strukturave shendetesore universitare. - Evidenca 29. Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27. - Evidenca 30.Konferenca vjetore 2023 FSHMT ne bashkepunim me UV dhe UISH. - Evidenca 79.Raporti Vjetor UMT 2020-2021. - Evidenca 79.1.Raporti Vjetor UMT 2021-2022. - Evidenca 80.Raport vjetor FSHMT 2020-2021. - Evidenca 81.Raport vjetor FSHMT 2021-2022.

	- Evidenca 82.Raporti vjetor FSHMT 2023.			
Konkluzione	UMT ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim formimin e studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të rëndësishme në vënd të tilla si: Qëndrat Universitare Spitalore "Koco Gliozheni" dhe "Mbretëresha Geraldinë".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Organizimi i programit të studimit bazohet në përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LAL dhe VKM 41, e ndryshuar. Po ashtu, bazuar në rregulloren e FSHMT, programi i studimit është i organizuar në përputhje me ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", programi është i organizuar në module, e lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Specifikisht kategoria A ze rreth 10% (2 lëndë), Kategoria B 42 % (7 lëndë), kategoria C 28% (7 lëndë), Kategoria D 10% (1 lëndë) dhe Kategoria E 10%. Bazuar në kategorizimin e lëndëve, numri më i lartë i krediteve (ECTS) është vendosur në dispozicion të lëndëve karakterizuese si: Procedurat depistuese dhe diagnostikuese gjinekologjike,

	Neuroendokrinologji e shtatzanise dhe gjinekologjike, Patologjitë e barrës, Fetusi pacient, Neonatologji, Infermieristika obstetrikale, Infermieristika gjinekologjike. Programi MP Mami ka kohëzgjatje 1 vit, 60 kredite, 13 module dhe 11 lëndë. Numri i orëve është i shpërndarë si më poshtë: - në auditor 746 orë, leksione 288 orë, seminare 66 orë - laborator 0, praktikë 390 orë, jashte auditorit 754 orë, projekte 2 orë. Evidencat: - Evidenca 2 Rregullore e UMT - Evidenca 5. Rregullore e FSHMT. - Evidenca 91. Plani mesimor Mami - Evidenca 97 Tabela permbledhese
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi MP Mami zgjat 1 vit, ka 60 kredite në total ku 6 nga këto kredite janë të provimit të diplomës. Programi i studimit synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e mamisë. Struktura e plotë është bazuar në praktikat më të miradhe lëndët/ modulet përbërëse synojnë të sigurojnë njohuritë themelore në këtë fushë nëpërmjet integritetit të mësimit me kërkimin. Modulet/lëndët që ofrohen ju sigurojnë studentëve një përgatitje të gjerë dhe mundësi që të përshtaten në tregun e punës dhe një gamë të gjerë të profileve në studimet e mëtejshme. Misioni i Programit MP Mami është përgatitja e profesionistëve me njohuri të kujdesit infermieror të nënës dhe fëmijës, që në përfundim të programit të studimit, të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë profesionale e shkencore për të shërbyer e për të qenë pranë nënës dhe fëmijës apo gruas me probleme të ndryshme shëndetësore që mund të hasin gjatë jetës. Evidencat: - Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MP në Mami - Evidenca 21. Rregullore FSHMT Mami. - Evidenca 91. Plani mesimor Mami
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Neni 96, pika 4 e Rregullores së UMT përcakton se përfundimi i një programi Master Profesional përmbyllet me provimin e diplomës. Kjo përcaktohet dhe në nenin 27, pika 4, që Studimet e ciklit të dytë "Master Profesional" përmbyllet me provim përfundimtar formimi. Kriteret e studenteve që diplomohen me provim formimi përcaktohen nga Dekanati. Ne përfundim të

	studimeve leshohet diplome “ Master Profesional” ne fushen e arsimimit te kryer. Provimi i diplomës bëhet në tre sesione diplomimi të cilat percaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejte të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomes. Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore. Ai është organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 1 vit studim / 2 semestra, me 60 ECTS në total dhe është i strukturuar në gruplëndë sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor. Programi përmban 11 lëndë dhe 13 Module (60 kredite ECTS në total), duke përfshirë provimin përfundimtar / (6 ECTS). Pjesë integrale e programit është praktika profesionale e cila zhvillohet në semestrin e dytë dhe ka 390 orë. Një nga ndryshimet me pozitive në riorganizimin e programit të studimit ka qënë shtimi i orëve të praktikës profesionale për të përafruar programin me direktivat evropiane për profesionet e rregulluara. Për këtë arsye, janë përfshirë orë shtesë brenda lëndëve në formën e praktikës lëndore duke përafruar në këtë mënyrë raportet teori / praktikë me praktikat evropiane. Evidencat: - Evidenca 9 Udhezues per hartimin e temes se diplomes - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore - Evidenca 21. Rregullore FSHMT Mami. - Evidenca 144.1.VKM 41 e ndryshuar 2023. - Evidenca 91. Plani mesimor Mami
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të	Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.

ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UMT nuk është një Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë.

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në udhëzimin e MAS Nr 31. Dt 15.11.2022 për “Proçedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti i Mjekësisë ka vendosur kodifikimin e programeve që oforn në fushën e vet. Duke marrë në konsideratë këto përcaktime, programi i studimit Master Profesional në Mami, reflekton përmbajtje të ngjashme në nivelin e kërkuar 70 %. Programi i përket nivelit 7 të EQAF ose KSHK (Korniza Shqiptare e Kualifikimeve), me aktin e hapjes së studimit VKM Nr. 23 datë 14.01.2009. Evidencat: - Evidenca 55.1.Lista e kodeve te programeve FSHMT - Evidenca 56. Procedura, afatet dhe dok. per hapjen e programeve te reja, riorganizimin dhe miratimin periodik te planeve. - Evidenca 55.Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Pavarësisht se UMT ka bërë një ndarje me kode të programeve të studimit që ofron, të gjithë institucionet e arsimit të lartë në vend janë në proces pritje të zyrtarizimit të kodeve të programeve të studimit nga grupi i punës që udhëhiqet nga MAS. Evidencat: - Evidenca 55.1.Lista e kodeve te programeve FSHMT - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga UMT.

Konkluzione	<i>Organizimi i programit të studimit bazohet në përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LAL dhe VKM 41, e ndryshuar. Po ashtu, bazuar në rregulloren e FSHMT, programi i studimit është i organizuar në përputhje me ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", programi është i organizuar në module, e lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Programi MP Mami zgjat 1 vit, ka 60 kredite në total ku 6 nga këto kredite janë të provimit të diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Ky program studimi, ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike i cili përbëhet nga 3 departamente, në total angazhohen: - për vitin akademik 2020-2021 për programin Master i Shkencave në "Mami" ishte 22 PAE (1 Prof. Dr., 3 Prof. As., 16 Dr., 2 Msc) dhe 141 PAK (7 Prof. As., 23 Dr., 89 Msc, 12 Mp, 10 Bsc) dhe 3 personel ndihmës; - për vitin akademik 2021-2022 për programin Master i Shkencave në "Mami" ishte 22 PAE (2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 13 Dr., 2 Msc) dhe 142 PAK (8 Prof. As., 24 Dr., 87 Msc, 13 Mp, 10 Bsc) dhe 3 personel ndihmës; - për vitin akademik 2022-2023 për programin Master i Shkencave në "Mami" ishte 22 PAE (2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 13 Dr., 2 Msc) dhe 135 PAK (3 Prof. As., 21 Dr., 94 Msc, 10 Mp, 7 Bsc) dhe 3 personel ndihmës. Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit është fakulteti ndërsa të gjitha njësitë bazë dhe strukturat e tjera kontribuojnë në realizimin me sukses të tij. Secila njësi bazë është përgjegjëse për

	lëndë/ grup-lëndësh të caktuara të cilat mbulohen nga stafet respektive. Drejtuesi i departamentit është përgjegjës për shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me personelin akademik, profilin dhe kualifikimet që ata kanë. Departamenti monitoron në mënyrë të vazhdueshme realizimin e të gjitha veprimtarive mësimore e shkencore për programin e studimit dhe aktivitetet e tjera në funksion të tij sipas rregullores së departamentit. Të gjitha proceset e vendimmarrjes në funksion të programit të studimit që ka nevojë për miratim, diskutohen gjerësisht në departamente dhe më pas në dekanat ku miratohen. Evidencat: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 2 Rregullore e UMT. - Evidenca 5.Rregullore-FSHMT.pdf - Evidenca 6. Rregullore Departamenti.pdf - Evidenca 7.Organigrama _Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike. - Evidenca 165.Te dhena statistikore _stafi akademik 2019-2024. - Evidenca 80 Raporti vjetor FSHMT 2020-2021. - Evidenca 81 Raporti vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82.Raporti vjetor FSHMT 2022-2023. - Evidenca 87.1. Shembull mbledhje departamenti vendimmarrje.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Neni 33 i Rregullores së FSHMT përcakton rolin dhe detyrimet e drejtuesit të praktikës i cili është personel akademik me kohë të plotë. Gjithashtu, përcaktohet dhe roli i laborantit. DLKIPISBP ka rekrutuar 85 mbikqyrës së praktikës profesionale (mentorë) dhe ka tre laborantë (dy me Msc dhe një me Dr). Për mbikqyrjen dhe mbarrëvajtjen e praktikave profesionale, FSHMT ka përgatitur dhe Ditarin e Praktikave Profesionale që bën të mundur ndjekjen dhe vlerësimin e studentit. Bazuar në planin mësimor të çdo viti akademik, fakulteti angazhon personel akademik me kohë të pjesshme, por peshën kryesore e zë personeli akademik efektiv i cili realizon përqindjen më të madhe të ngarkesës totale të programit të studimit, respektivisht 55 % janë PAE dhe 45 % PAK. Në takimet e zhvilluara me titullarët e FSHMT, si dhe bazuar në evidencat përkatëse të DVV, theksojmë

	faktin se ngarkesa prej 45% mbulohet nga personel i strukturave shëndetësore universitare të cilat janë pjesë integrale e UMT, në zbatim të VKM-ve përkatëse (evidenca nr.144 në DVV) dhe Statutit të UMT. Për zhvillimin e praktikave profesionale angazhohen kryemamitë dhe mamitë nga dy maternitetet (spitale universitare). Një kontribut të rëndësishëm në realizimin e programit të studimit jep personeli ndihmës akademik i cili angazhohet në realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale. Evidencat: - Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore - Evidenca 13.1; 13.2; 13.3 Ditar i praktike - Evidenca 96.CV-te e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. - Evidenca 97 Tabela permbledhese Evidenca 165.Te dhena statistikore stafi akademik 2019-2024 - Evidenca 97.2 Tabela me statistikat permbledhese Mami.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të nenit 10 të Rregullores së departamentit, Koordinator i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarvajtjen e programit dhe praktikave profesionale. Fakulteti ka caktuar në rolin e koordinorit të programit të studimit , përgjegjës në departamentit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj. Koordinatori i programit informon vazhdimisht drejtuesin e fakulteti qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takimet e dekanatit (duke qënë se është pjesë përberëse e tij) që realizohen gjatë vitit akademik. Evidencat: - Evidenca 5. Rregullore - FSHMT. - Evidenca 6. Rregullore Departamenti. - Evidenca 87. Shembull njoftim mbledhje departamenti vendimmarrje.

Konkluzione	Ky program studimi, ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike i cili përbëhet nga 3 departamente. FSHMT përmbush të gjitha detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me numrin e personelit akademik, kualifikimet, ngarkesën, numrin e lëndëve të zhvilluara dhe përputhshmërinë e lëndës me përgjegjësin e saj. Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme ndërsa me më shumë informacione për këtë program studimi MP në “Mami” paraqiten në Rregulloren e Njesisë Kryesore, Njesisë Bazë dhe në rregulloren e programit të studimit. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë ata raportuan se i gjithë dokumentacioni është i disponueshëm pranë Njesisë Bazë përfshirë rregulloren, planin mësimor, syllabuset si dhe literaturën bazë. FSHMT si njësia kryesore përgjegjëse për organizimin e programit të studimit, disponon dokumentacionin e plotë për programin e studimit MP Mami. Ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar dhe ka respektuar kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, e ndryshuar, të kategorizuara në - A.Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 kredite), - B. Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: (25 kredite),

	- C. Lëndë Ndërsiplinore/Integruese, Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (17 kredite), - D.Lëndë Plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përfitim të aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikë: (6 kredite), - E. Detyrime Përmbyllëse: Teza e diplomës, ose provimi i formimit: (6 kredite). Evidencat: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit MP në "Mami"; - Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MP Mami - Evidenca 91 Plani mesimor Mami
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Organizimi i programit të studimit bazohet në përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LAL dhe VKM 41, e ndryshuar. Po ashtu, bazuar në rregulloren e FSHMT, programi i studimit është i organizuar në përputhje me ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", programi është i organizuar në module, e lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Specifikisht kategoria A ze rreth 10% (2 lëndë), Kategoria B 42 % (7 lëndë), kategoria C 28% (7 lëndë), Kategoria D 10% (1 lëndë) dhe Kategoria E 10%. Bazuar në kategorizimin e lëndëve, numri më i lartë i krediteve (ECTS) është vendosur në dispozicion të lëndëve karakterizuese si: Procedurat depistuese dhe diagnostikuese gjinekologjike, Neuroendokrinologji e shtatzanise dhe gjinekologjike, Patologjitë e barrës, Fetusi pacient, Neonatologji, Infermieristika obstetrikale, Infermieristika gjinekologjike. Programi MP Mami ka kohëzgjatje 1 vit, 60 kredite, 13 module dhe 11 lëndë. Numri i orëve është i shpërndarë si më poshtë: - në auditor 746 orë, leksione 288 orë, seminare 66 orë laborator 0, praktikë 390 orë, jashtë auditorit 754 orë, projekte 2 orë..

	<table><tr><th>MP në “Mami”</th><th>Viti I</th></tr><tr><td>Në auditor</td><td>746</td></tr><tr><td>Leksione</td><td>288</td></tr><tr><td>Seminare</td><td>66</td></tr><tr><td>Laboratore</td><td>0</td></tr><tr><td>Praktike lëndore</td><td>390</td></tr><tr><td>Jashtë Auditorit</td><td>754</td></tr><tr><td>Praktika profesionale</td><td></td></tr><tr><td>Detyra/Projekte</td><td>2</td></tr></table>	MP në “Mami”	Viti I	Në auditor	746	Leksione	288	Seminare	66	Laboratore	0	Praktike lëndore	390	Jashtë Auditorit	754	Praktika profesionale		Detyra/Projekte	2
MP në “Mami”	Viti I																		
Në auditor	746																		
Leksione	288																		
Seminare	66																		
Laboratore	0																		
Praktike lëndore	390																		
Jashtë Auditorit	754																		
Praktika profesionale																			
Detyra/Projekte	2																		
	GVJ konstaton se raporti orë në auditor (746) me orë individuale (754) është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Evidencat: - Evidenca 86 - Evidenca 91 Plani mesimor Mami - Evidenca 92. Syllabuse MAMI. - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit MP në “Mami”; - Evidenca 108. Aktivitete të Zyres së Karrieres FSHMT - Evidenca 107. Manuali i keshillimit të karrieres fshmt.																		
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Neni 4 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 108 i rregullores së Institucionit UMT përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njesisë Kryesore, në nenet 35 dhe 36 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. Neni 46; 47: 48 i Rregullores së Departamentit përmend Njohjen dhe Ekuivalentimin e studimeve, diplomave dhe kalimin nga një program studimi në një tjetër. Në rregulloren e programit të studimit neni 10 përcakton “politikat e pranimit”. Neni 31 dhe 32 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton shkëputjen dhe ndërprerjen e studimeve. Kriteret e pranimit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati. Plani mësimor në fillim të çdo viti akademik miratohet në Dekanat dhe zbatohet për vitin në vijim. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulin, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS;																		

	objektivat e modulit; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturë. Rregullorja e universitetit parashikon rastet dhe sasinë e krediteve respektive që njihen. Janë parashikuar edhe programet e dyta të studimeve, si dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre. Evidencat: - Evidenca 1 Statuti i UMT;; - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP; - Evidenca 2.Rregullore e Universitetit te Mjekesise Tirane. - Evidenca 5.Rrregullore FSHMT. - Evidenca 21.Rregullore fshmt Mami. - Evidenca 91 Plani mesimor Mami - Evidenca 92. Syllabuse MAMI. - Evidenca 139.Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave te pranimit ne c1, PICD dhe te ciklit te dyte ne UMT - Evidenca 98.1.Tabela me statistikat e studenteve.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Sipas nenit 9 të Rregullores së FSHMT, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzoj atë në Departament. Syllabuset e lëndëve janë përshtatur në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar, duke pasqyruar të gjithë elementët që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi. Çdo syllabus përmban informacionet e nevojshme për praktikant, seminarin, orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Syllabuset përditësohen në fillim të çdo viti akademik, dhe dorëzohen në formatin elektronik dhe të firmosura nga titullarët e lëndëve. Evidencat: - Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore; - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP - Evidenca 21 Rregullore progami bachelor Mami - Evidenca 92. Syllabuse MAMI. - 91.Piani mesimor Mami fq 5 23-26
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe	Programi i studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, përfshirë këtu, syllabuset, literaturën, kriteret e pranimit etj. Ky proces iniciohet me Urdhër të Rektorit të

përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	universiteti i cili kërkon në përfundim të çdo viti akademik që fakultetet dhe departamentet e universitetit të kryejnë ndryshime eventuale në programet e studimit nën masën 20 % në përputhje me aktet në fuqi. Evidencat: - Evidenca 11. Praktike per miratimit e planeve mesimore.PDF - Evidenca 11.1 Praktike per propozim ndryshimesh ne planet mesimore DLK IPISBP viti akademik 22-23. - Evidenca 56. Procedura, afatet dhe dok. per hapjen e programeve te reja, riorganizimin dhe miratimin periodik te planeve.			
Konkluzione	Programi i studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, përfshirë këtu, syllabuset, literaturën, kriteret e pranimit. Sipas nenit 9 të Rregullores së FSHMT, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzoj atë në Departament. Neni 4 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrës Kombëtare dhe Evropiane të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, janë ndërtuar të tilla duke ofruar një bazë të gjerë njohurish në fushën e shkencave mjekësore, t'u mundësojnë studentëve punësimin në një shkallë të gjerë. Komponentët mësimorë si mësimi në auditor (leksione, seminare, praktika, laboratorë si dhe kontrolli i vazhdueshëm) është në

mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogun e lëndës dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe praktik. Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Lëndë të caktuara, në varësi të specifikave, aplikojnë veprimtari të ndryshme në funksion të mësimdhënies duke respektuar lirinë akademike dhe njëkohësisht për të nxitur studentët të krijojnë në mënyrë të pavarur, të praktikohen më shumë në laboratorë dhe praktikë. <i>Të dhënat e ALUMNI për punësimin e studentëve në këtë program janë rreth 97% brenda apo jashtë vendit.</i> Evidenca: - Evidenca 91 Plani mesimor në Mami; - Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 21 Rregullore programi mami; - Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shendetesore universitare. - Evidenca 117 Lista e laboratoreve didaktike në të 3 Fakultetet - UMT. - Evidenca 117.1 Laboratori i infermieristikes
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Ky program studimi është organizuar sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. dt. 24.01.2018, e ndryshuar. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në ore/kreditë) është përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore, duke synuar njëkohësisht përafrimin me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe zbatuar direktivat kombëtare dhe evropiane për profesionet e rregulluara. Pika 2.5 e VKM përcakton qartë veprimtaritë formuese të cilat janë të reflektuara në planin mësimor. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një modul. Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, departamentet dhe personeli akademik, përveç eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerë dhe bashkëpunëtorët si Urdhri i infermierit, studentë të diplomuar etj. Fakulteti dhe departamentet analizojnë ecurinë e programit të studimit, duke përfshirë në të mendimin dhe opinionin e lektorëve por edhe të studentëve lidhur dhe me programin e çdo moduli. Bazuar në opinionet dhe mendimet e marra programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit duke përfshirë këtu edhe ndryshime të mundshme të syllabuseve.

	Evidencat: - Evidenca 91 Plani mesimor në Mami; - Evidenca 27 Pyetësi i studenteve fshmt 23
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit MP Mami, ofron njohuri teorike dhe praktike që u mundësojnë studentëve autonomi në vendimarrje, analiza të situatave që ata mund të hasin gjatë ushtrimit të profesionit së tyre. Nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët, studentëve u mundësohet një përgatitje e lartë profesionale, avancim në fushën e studimit në ciklin e trete e më tej. Raporti i orëve të praktikës krahasuar me ato në laborator është respektivisht: 390 orë praktike dhe 364 orë teorike. GVJ sugjeron që ky raport të rritet në favor të orëve të praktikës duke qenë se programi është me orientim profesional. Evidencat: - Evidenca 108. Aktivitete të Zyres së Karrierës FSHMT - Evidenca 109 Analize vjetore sekretaria mesimore;
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e veprimtarive mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Lëndët të caktuara, në varësi të specifikave, aplikojnë veprimtari të ndryshme, me qëllim arritjen e objektivave që ka programi i studimit. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në ore/kredite) është përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore, duke synuar njëkohësisht përafrimin me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe zbatuar direktivat kombëtare dhe evropiane për profesionet e rregulluara. Natyra e lëndëve,/ moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep secila prej tyre. Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, departamentet dhe personeli akademik, përveç eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerë dhe bashkëpunëtorët si Urdhri i infermierit, shoqata të ndryshme, studentë të diplomuar etj. Në përfundim të studimeve, punësimi është i mundur. GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e të diplomuarve nuk punojnë në profilin e tyre. Evidencat: - Evidenca 91 Plani mesimor në Mami; - Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;

Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	- <i>Evidenca 21 Rregullore programi mami;</i> Duke respektuar “lirinë akademike”, pedagogut i kërkohet të hartojë një plan kursi (Syllabus) përpara fillimit të vitit akademik, duke respektuar parimet bazë kurrikulare të lëndës. Çdo program mësimor analizohet në detaje nga drejtuesi i departamentit dhe në formën përfundimtare i paraqitet për miratim Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Të gjitha planprogramet ofrojnë informacion të detajuar mbi metodën e mësimdhënies, elementet e vlerësimit të studentëve, literaturën bazë dhe të sugjeruar, etj., duke ofruar informacion të detajuar për studentët dhe duke përmbushur kriteret e saj. Lëndët e ofruara në këtë program studimi programi janë të pajisura me literaturë të përditësuar të viteve të fundit. Evidenca: - <i>Evidenca 91.Plani mesimor MP Mami 23-26;</i> - <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MP Mami;</i> - <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Profesional Mami;</i> <i>Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në objektivat e programit, përmbajtja e tij synon të prodhojë profesionistë dhe studentë të mamise të cilët me njohuritë e tyre do të jenë lider të ardhshëm në departamentet e tyre përkatëse në fushën e Obstetrike-gjinekologjisë. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet nga drejtuesit e departamenteve të cilët njëkohësisht monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Rishikimi apo përditësimi në përmbajtje të programit të studimit kryhet çdo vit akademik dhe inicohet në nivel institucional për të gjitha programet e universitetit . Plan i mësimor i miratuar nga Senati akademik dhe dosja e plotë e programit zbatohet në vitin akademik pasardhës. Evidencat - <i>Evidenca75Vendim i perbashket Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit per veprimtarine e UMT.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me	Përmbajtja e programit, syllabuseve, përshtatja sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, kryhet nga departamentet përgjegjëse nuk ka patur ndryshim këto 3 vite . Nga konsultimi i vazhdueshëm, merren parasysh propozimet e tyre, studentëve, bashkëpunëtorëve dhe partnerëve që janë pjesë e tregut të punës. Përmbajtja është e tillë që t’u ofrojë studentëve njohuritë e nevojshme për të ndjekur

pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	më tej ciklin e e tretë të studimeve. Thellimi në studime dhe analiza është e mundur nëpërmjet bashkëpunimit të studentëve me personelin akademik ose nga vetë aktivitetet studentore. Bazuar në informacionet e dhëna nga të punësuarit, rezulton që studentët e diplomuar në FSHMT të jenë nga më të kërkuarit në tregun e punës për shkak të përgatitjes së lartë teorike dhe profesionale e tyre, e cila evidentohet edhe në provimet e licensimit apo të portalit të punësimit, rezultat merren nga të dhënat e siguruara nga QSHA, e cila administron provimin e shtetit për marrjen e licencës së ushtrimit të profesionit të mamise. Evidencat: - Evidenca 120 Te dhena per Alumni nga Udhrat profesional; - Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT.			
Konkluzione	Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. Në total ky program ofrohet në një vit akademike dhe kërkon angazhimin për 1500 orë nga të cilat 746 orë në auditor dhe 754 ore jashtë auditorit. Programi përfshin teori dhe praktikë. Në total studentët gjatë studimeve të tyre zhvillojnë 288 orë leksione, 66 orë seminaredhe 390 orë praktikë profesionale. Nuk u raportuan mobilitete për studentët e këtij programi studimi, por institucioni ofron për studentët mundësi mobiliteti. Janë mbi 10 marrëveshje me projekte Erasmus + dhe kjo është pikë pozitive. Ka një përfshirje të stafit akademik në këto projekte. Pjesa dërrmuese e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi janë të punësuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



33



Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	UMT të ofron programe studimi të përshtatura me tregun e punës. Drejtuesia e Njesisë Kryesore raportoi se janë munduar të përshtasin programet e studimit sipas nevojave. Institucioni raporton se mundohet brenda 20% të përshtasë programin e studimit. Stafi akademik raportoi se rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit ka përgjegjësi i departamentit. Në takimin e organizuar me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, drejtuesit e FSHMT, si dhe stafin akademik të FSHMT, kostatojmë se për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, departamentet dhe personeli akademik, përveç eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerë dhe bashkëpunëtorët si Urdhri i infermierit, shoqata të ndryshme, studentë të diplomuar etj. Pothuaj i gjithë personeli akademik i UMT/FSHMT me tituj/grada është i angazhuar si ekspert në fushën e sigurimit të cilësisë qoftë në akreditimin e institucioneve shëndetësore dhe në akreditimin e programeve të studimit që ofrojnë IAL në vend. <i>Për këtë arsye GJV vlerëson se FSHMT disponon ekspertizën më të mirë në vend në fushën e arsimit dhe shëndetësisë.</i> Për më tepër, në çdo veprimtari të zhvilluar për edukimin në vazhdim dhe sigurimin e cilësisë, FSHMT ka angazhuar vazhdimisht partnerë e bashkëpunëtorë të jashtëm nga institucione partnere ose alumni dhe aktorë të tjerë në funksion dhe të përmirësimit të programit të studimit. Evidenca: - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Sipas parashikimeve ligjore, Senati Akademik i UMT, ka në përbërjen e vet dhe student, neni 25, pika 3 Statuti i UMT. Paralelisht, Institucioni ka ngritur dhe Këshillin studentor. Studentët janë dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme që Institucioni ngre (përfshirë këtu edhe procesin e akreditimit). Gjithashtu ekzistone senatori i klasës i cili bënë urën lidhëse midis studentëve dhe strukturave dhe funksiononte më së miri. Këto u konfirmuan edhe në takimin e zhvilluar me studentët. Nga ana tjetër, raportuan se kanë gjithnjë një derë të hapur nga Drejtuesia e Njesisë Kryesore në rast se kanë problematika të ndryshme. Studentët raportuan se janë thirrur nga Drejtuesi i Departamentit dhe kanë dhënë mendimin e

	tyre për organizimin e konferencës. Vlerësimi i stafit akademik nga studentët është diçka pozitive. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 126 Rregullore e zgjedhjeve të Keshillit Studentor UMT - Evidenca 125 Perberja e Këshillit Studentor UMT - Evidenca 127 Statuti i Keshillit Studentor UMT - Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve konferenca e shkencave mjekësore; - Evidenca 27 Pyetësi i studentëve fshmt 23; - Evidenca 28 Rezultatet pyetësorit studentët 23 - Takim me studentët.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<i>FSHMT bashkëpunon dhe merr në konsideratë çdo dokument, raport, publik, analizë që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së studentëve të diplomuar. Edhe raportet e UISH kanë qenë, janë dhe do të jenë në mënyrë të vazhdueshme pjesë e analizës për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së studentëve dhe zhvillimit profesional të tyre. Ky konstatim u evidentua nga takimet me drejtuesit dhe stafin akademik të FSHMT. Gjithashtu, institucioni ka raportuar komunikimin zyrtar me UISH me qëllim identifikimin e kalueshmërisë në provimin e licencës. GVJ konsideron të rëndësishme dhe pikë të fortë zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me UISH, në funksion të përmirësimit dhe përditësimit të programit të studimit.</i> Evidenca: - Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik.			
Konkluzione	<i>FSHMT ka kryer përditësimin/përmirësimin e programit të studimit në vlerësim, brenda 20% të totalit të krediteve. Janë përfshirë institucione partnere si alumni dhe aktorë të tjerë për përmirësimin e programit të studimit. Studentët raportuan se janë përfshirë në përmirësimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	UMT dhe FSHMT u krijojnë mundësi studentëve dhe stafit për të nxitur kërkimin shkencor, gjë e cila i ndihmon personat e interesuar që të ndjekin programe të tjera studimi më pas. Por pavarësisht këtij fakti, programi i studimit MP në Mami ka në fokus zhvillimin e praktikave të specifikuara dhe përgatitjen në kohë të shpejtë të profesionistëve të rinj të cilët janë të gatshëm për të dalë në tregun e punës menjëherë pas diplomimit. Evidencat: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 91 Plani mesimor në Mami; - Evidenca 21 Rregullore programi bachelor mami;
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	UMT zbaton nenin 3 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe legjislacionin e brendshëm. UMT respekton dhe garanton lirinë akademike në mësimdhënie, mësimnxënie, kërkim shkencor dhe risi. Bazuar në objektivat e përcaktuara nga Departamenti, në fillim të çdo viti akademik, ngarkesa e lëndëve, kërkimi shkencor dhe detyra të tjera, i ndahen stafit akademik. Lëndët e shpërndara për personelin akademik janë sigurisht në përputhje me ekspertizën e tyre profesionale dhe interesin kërkimor. Nga ana tjetër, Përgjegjësi i Departamentit fokusohet në mënyrën e realizimit të veprimtarive akademike, praktikës dhe kërkimit si pjesë e programit të studimit. Evidencat: - Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; - Evidenca 21 Rregullore programi mami; - Evidenca 156. Formular Vlerësimi i performances së stafit akademik.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime,	Programi i studimit është organizuar në mënyrë të tillë që veprimtaritë formuese të reflektojnë nevojën që ka studenti për të përvetësuar përmbajtjen e saj. Për këtë arsye disa lëndë kanë në përbërje një komponent praktik, i cili fokusohet në projekte aplikative dhe kërkim shkencor. Studentët, së bashku me profesorët

projekte dhe aktivitete kërkimore.	përkates, bëhen aktiv në projektet kërkimore në UMT nëpërmjet detyrave të ndryshme që organizohen në lëndë të ndryshme. Evidencat: - Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve knonferenca; e shkencave mjekesore - Evidenca 16 Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studenteve. FSHMT. - Evidenca 14 Lista e aktiviteteve të Keshillit Studentor UMT.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Pavarësisht se administrimi i programit kryhet në nivel njësie kryesore, departamentet gjatë gjithë vitit akademik, bashkërendojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore në bashkëpunim me personelin akademik respektiv duke integruar dhe studentët. Nëpërmjet orientimit nga personeli akademik, studentët angazhohen dhe marrin pjesë në punime, projekte, aktivitete të karakterit studimor dhe kërkimor shkencor. Angazhimi në kërkim shkencor, nga njësitë, personeli akademik dhe studentët kërkon mbështetje në formë të ndryshme nga ana e fakultetit. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete që zhvillon fakulteti ze vazhdimisht një vend të rëndësishëm. Këtu përmendim mbështetjen e studentëve në Kongresin e shkencave mejekeësore. Pavarësisht mbështetjes së ulët financiare të fakultetit, personeli akademik nëpërmjet financimeve alternative, projekteve dhe donacioneve, angazhohet në kërkim dhe mobilitet. Ndërsa studentët hasin vështirësi pasi Fakulteti ka mundësi të limituara financiare të mbështesë studentët për mobilitete jashtë vendit ose të ftojë studentë të huaj për periudha të shkurtra kohe. Megjithatë, FSHMT ka intensifikuar përpjekjet për gjetjen e burimeve alternative të financimit për të mbështetur stafin dhe studentët si programet Erasmus +, Programet COST, projekte të AKKSHI etj. Shumica e studentëve të Fakultetit janë studentë me rezultate të larta, ata nuk paguajnë tarifë shkollimi e për më tepër marrin dhe bursa për zhvillimin e studimeve të tyre. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë, ata raportuan se kërkimi shkencor është një pikë prioritare për UMT dhe për këtë arsye, Institucioni ka përcaktuar një fond (1,000 euro për çdo pedagog) për punime shkencore. Stafi ka përfituar nga ky grant. Evidencat:

	- Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve knonferenca e shkencave mjekesore; - Evidenca 6 Rregullore Departamenti. - Evidenca 44Lista e projekteve nderkombetare te aplikuar dhe te fituara. - Evidenca 44.1 Projekte nderkombetare te fituara - Evidenca 52Praktike per miratimin e buxhetit vjetor UMT. - Evidenca 130 Politika dhe praktika per fitimin e bursave te studenteve dhe perjashtimi nga tarifa vjetore e studimit.			
Konkluzione	Misioni dhe Veprimtaria e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në Nenin 6 dhe 7 të Rregullores së programit të studimit. Staf i akademik gëzon liri akademike në kërkim shkencor dhe mësimdhënie. Staf i akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve dhe punimeve shkencore. Kjo është një praktikë shumë e mirë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Drejtuësit e Njësive Kryesore dhe Bazë raportuan se kanë aplikuar në projekte kërkimore shkencore. Gjatë vizitës në FSHMT, GVJ u vu në dijeni të disa projekteve të përfunduara ose që janë në zhvillim. GVJ konstatoi gjatë vizitës në vend, se si rezultat i një projekti të fituar dhe zhvilluar në FSHMT është ngritur një nga sallat më të mira laboratorike në vend në fushën e mamisë. GVJ konsideron një pikë të fortë të FSHMT aplikimin dhe fitimin në disa projekte kërkimore dhe infrastrukturore, duke mbështetur rritjen në vijimësi të numrit të aplikimeve në projekte kërkimore shkencore. Evidenca: - Evidenca 152 Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT

	- Evidenca 153.1 Raportim i aktivitetit shkencor personel akademik 20-23 - Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit 20-23 - Evidenca 154 Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT - Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mesimore shkencore ne UMT - Evidenca 182 Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Botimeve UMT VSA nr.42 datë 29.04.2022; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me GVB;
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Në kuadër të kërimit shkencor stafi akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e UMT. Në raportin vjetor të Njesisë Bazë prezantohen publikimet e stafit akademik, ndërsa në mënyrë të përmblëdhur paraqiten në raportin vjetor të Njesisë Kryesore dhe Institucionit. Evidenca: - Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT - Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT - Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Institucion raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, ëorkshope etj. të cilat u vinë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Paralelisht, ka organizuar konferencë studentore. Aktivitetet e organizuara raportohen si në raportin e Njesisë Bazë edhe në raportin vjetor të Institucionit. Vlen të përmendet që IAL-ja ofron edhe ndihmë financiare për stafin akademik për publikime në revista me impakt (deri në 1000 euro) dhe gjithashtu i jep mundësinë studentëve që të angazhohen me punimet e profesorëve të tyre. Evidenca: - Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT - Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT - Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP

	- Evidenca 152 Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT - Evidenca 153.1 Raportim i aktivitetit shkencor personel akademik 20-23 - Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit 20-23 - Evidenca 154 Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT - Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mesimore shkencore ne UMT - Evidenca 182 Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Botimeve UMT VSA nr.42 datë 29.04.2022; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programet e studimit në UMT janë konkurruese ndërkombëtarisht në elementët që përmbajnë. Kjo tashmë njihet gjërësisht dhe ka detyruar Qeverinë shqiptare të ndërmarrë masa konkrete për të kufizuar largimin e profesionistëve të shëndetësisë. Edhe programi MP Mami është krijuar me synimin që të përgatisë studentë të aftë profesionalisht të punësohen brenda dhe jashtë vendit , çka është arritur më së miri. Evidencat: - Evidenca 154 Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	FSHMT është pjesë integrale e rrjetit të profesionistëve brenda dhe jashtë vendit. Per rrjedhojë bashkëpunimi me urdherat e profesionistëve është tashmë i konsoliduar. Veçanërisht i frytshëm është bashkëpunimi me Urdhërin e infermierit me të cilin jo vetëm janë të anëtarësuar të gjithë studentët që diplomohen, por koordinohen veprimtaritë për zhvillimin e praktikës pas përfundimit të studimeve, zhvillimit të provimit të shtetit, licensimit të studentëve pas përmbushjes së detyrimeve etj. Ndërkohë bashkëpunimi prek edhe çështje të tjera si hartimi i dokumenteve e akteve rregullatore, organizimin e eventeve, konferencave etj. Evidencat: - Evidenca 30 Konferenca vjetore 2023 FSHMT me bashkepunim me UV dhe UIISH.

Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Një nga synimet e Fakultetit ka qënë përshtatja e programeve që FSHMT ofom në përputhje me kornizën ligjore dhe direktivat evropiane për profesionet e rregulluara. Fakulteti ka bashkëpunuar me MAS për të gjetur mekanizmat e përshtatjes së programeve me direktivën <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>. Programet që aktualisht FSHMT ofron, përmbushin këto detyrime dhe studentët lehtësisht punësohen në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian. Evidencat: <i>Evidenca 48. Shembull marreveshje bashkepunimi me IAL nderkombetare.</i>			
Konkluzione	<i>Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë raportuan se mundohen të aplikojnë në projekte kërkimore shkencore. GVJ konsideron të rëndësishme dhe të fortë këtë pikë, si dhe mbështet institucionin që numri i aplikimeve në projekte kërkimore shkencore të rritet. Në kuadër të kërkimit shkencor staf akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e UMT. Institucion raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, ëorkshope etj. të cilat u vinë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Programi i studimit Master Profesional në “Mami” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit Europian.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Musleu

[Signature]
 41

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	FSHMT angazhohet maksimalisht që i gjithë procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike të realizohen në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe duke respektuar lirinë akademike. Metodatat e transmetimit të njohurive tek studentët janë të shumta dhe në varësi të llojit/ specifikës së veprimtarive formuese, programi i studimit por edhe lirisë së veprimit që ka personeli për zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies. Në këtë program parashikohen 11 lëndë (së bashku me praktikën dhe provimin përfundimtar), 13 module. Ndërthurja e teorisë me praktikën në pothuaj të gjitha lëndët/modulet e formimit bazë dhe specifik përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre, mundëson realizimin me sukses të veprimtarive të parashikuara. Avantazhi i FSHMT si pjesë e UMT dhe QSUT, mundëson për studentët, kryerjen e veprimtarive teorike e praktike në mjedise spitalore me pacientë realë. Evidencat: - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 86 Program Mami Bcs 2020-2023; - Evidenca 91.Plani mesimor Master Profesional ne Mami; - Evidenca 123 Shembull Broshure Informuese Fshmt
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjen e tij sa më të përshtatshëm për studentët. Staf i akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PoëerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët. Në periudhën e pandemisë, UMT, ka përdorur dhe mësimdhënien on-line por jo më. Evidenca: - Evidenca 146 Serbimi i Telemjekesise - Evidenca 147 Pershkrim i funksionaliteteve te platformes E-UMT - Evidenca 148 Pershkrim funksionaliteteve te platformes EasyEeb LMS

	- Evidenca 42 Nderfaqe EasyËeb (per lenden) - Evidenca 79 Raporti Vjetor _UMT_ 2020-2020 - Evidenca 85 Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2021 - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, UMT, organizon trajnime për stafin akademik. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se Zyra e Kërkimit Shkencor ka marrë ekspertë nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve. Paralelisht, u dërgojnë thirrje për aplikime të ndryshme si dhe website. Në dokumentacionin e kërkuar pas vizitës së GVJ, është dërguar evidenca E.5.3 "Lista e aktiviteteve në kuadër të sigurimit të cilësisë (përfshirë trajnimet)", si edhe E.5.1 "Trajnim stafi FSHMT lidhur me hartimin e kurrikulave" (trajnim në bashkëpunim me HAP për hapjen e programit të ri Mp. Infermieri familje), si dhe E.5.2 "Përmbledhje takimi HAP_staf pedagogjik_Master Inf familje". Evidenca: - Evidenca 45 Lista e projekteve kombetare të aplikuara dhe të fituara - Evidenca 19.Aktiviteti dt 14 Nentor 2023 në FSHMT - Takim me stafin akademik; - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Takim me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie ka njohuritë dhe aftësitë e duhura. Stafi akademik ka aftësitë e duhura didaktike me qëllim shpjegimin në mënyrën më të mirë të mundshme studentëve. Studentët raportuan se janë të kënaqur nga mësimdhënia që zhvillon stafi akademik. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PoëerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Kjo u konfirmua nga studentët. Gjatë takimit me autoritete drejtuese, ata raportuan se mundohen të rekrutojnë staf me eksperiencë në mësimdhënie. Kjo u raportua dhe në takimin me Burimet Njerëzore. CV-t e pedagogëve tregojnë se ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në mësimdhënie. UMT organizon aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik.

	Evidenca: - Evidenca 96 CV-te e personelit akademik te angazhuar ne programin e studimit; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Burimeve Njëerëzore.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët, njëri për lëndën dhe tjeri për institucionin. Kjo është një procedurë standarde që UMT përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithshme informohen për rezultatet. Studentët konfirmuan që vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësonin online dhe e plotësojnë. Në takimin e përfaqësuesit të NJSBC u tregua në mënyrë të detajuar procedura e zhvillimit të pyetësorëve. Me qëllim zhvillimit të pyetësorit të studentëve në mënyrë të paanshme FSHMT ka kontaktuar ekspertë jashtë institucionit. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. Pjesëmarrja e studentëve në vlerësim nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar sepse plotësimi i pyetësorit ka qenë me dëshirë. Ky fakt ka të bëjë dhe me numrin e vogël të studentëve në këtë program studimi (master profesional). Evidenca: - Evidenca 67 Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për lëndët e programit të studimit formular - Evidenca 68 Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me	Institucioni ka në përbërjen e vet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata organizojnë aktivitete të ndryshme duke përfshirë dhe ekspert të jashtëm (shih përshkrimin në kriterin 3 të këtij standardi).

njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Evidenca: - <i>Evidenca 3 Organigrama UMT;</i> - <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>			
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjen e tij sa më të përshtatshëm për studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PoëerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët. Sugjerojmë që FSHMT të gjejë instrumentat e duhura në mënyrë që të rritet pjesëmarrja studentëve në plotësimin e pyetësorëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Neni 86 i Rregullores së institucionit, neni 16 i Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 17 i Rregullores së Programit të studimit raportojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Në syllabuset e lëndëve/moduleve raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70% 2. Provimi të ndërmjetëm 15%

	3. Aktivizimi 10% 4. Frekuentimi 5% Vlerësimi i tezës së provimit është pjesë e vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare, laboratore, provimit të ndërmjetëm etj), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës. Në sezonet e vjeshtës ose të riprovimeve vlerësimi bëhet me tezë 100 pikëshe dhe vlerësimet e studentit të akumuluar gjatë vitit zerohen. Vlerësimi përfundimtar mund të ndryshohet vetëm me rifutjen në provim për përmirësim. Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 4 deri 10), me pikë ose me përgindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik dhe nga studentët gjatë takimeve të zhvilluara. Vlerësimi detajohet në syllabuset e lëndëve. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion është po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve. Informimi i studentëve orën e parë të modulit u konfirmua dhe gjatë takimeve si nga stafi akademik po ashtu dhe nga studentët. Kjo procedurë është transparente dhe studentët kanë të gjithë informacionin e duhur në lidhje me metodologjinë e vlerësimit. Evidenca: - Evidenca 92 Syllabuset Master Profesional mami; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	Sipas nenit 17 të Rregullores së Njesisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me

demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

shkrim dhe me gojë. Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato fakultative: zgjedhja e lëndëve fakultative është në pëlqimin e studentit. Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe provimit me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pike) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.

Evidenca:

- Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;
- Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mami";
- Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MP Mami;
- Evidenca 92 Sillabuset Master Profesional mami;
- Takim me stafin akademik;
- Takim me studentët.

Konkluzione

Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të provimi përfundimtar (70%), provimi të ndërmjetëm (15%), (10%) dhe frekuentimi (5%). Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektesh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë.

Shkalla e përmbushjes së standardit

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e Programit të studimit (neni 16) raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe në syllabuse raportohet se nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70% 2. Provimi të ndërmjetëm 15% 3. Aktivizimi 10% 4. Frekuentimi 5% Sipas nenit 17 të Rregullres së Njesisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pike) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Evidenca: - Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master profesional në "Mami"; - Evidenca 92 Sillabuset Master profesional Mami; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	UMT ka marrëveshje me CleanScore për zbatim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit. Me qëllim vlerësimi të jetë

ndryshme abuzimi dhe risin transparencën.	i drejtë dhe i pa anshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. Evidenca: - <i>Evidenca 145 Relacion cleanscore;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi zhvillohet në bazë të nenit 88 të Rregullores së institucionit, nenit 16 të Rregullores së Njesisë Kryesore dhe nenit 17 të Rregullores së Programit të studimit. Në këto nene raportohen kriteret dhe mënyrat e tesimit dhe vlerësimit të dijeve. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Evidenca: - <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> - <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;</i> - <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mami";</i> - <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MP Mami;</i> - <i>Evidenca 92 Syllabuset Master Profesional Mami;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora ose në klasë. Studentët raportuan se në raste që kanë paqartësi mund të pyesin pedagogët për gabimet e tyre. Kjo është një procedurë që u konfirmua dhe nga stafi akademik. Evidenca: - <i>Evidenca 40 Nderfaqe sistemi PITAGORA.</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk	Përdorimi i matërialeve të ndaluara, kopjimi etj. nuk lejohen. Në syllabuset e lëndëve është i përcaktuar dhe kodi i etikës ku detajohen veprimet që nuk lejohen nga studentët, përfshirë këtu

lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	kopjimin, plagjiaturën etj. Institucioni ka marrëveshje me Akademia për përdorimin një sistem antiplagjature me pagesë. Kjo u konfirmua nga drejtuesit e Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë. Evidenca: - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mami”; - Evidenca 92 Sillabuset Master Profesional Mami; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Studentët informohen mbi rezultatet e provimit sipas afateve ligjore që parashikohen në Rregulloren e programit të studimit. Korrigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar dhe brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit dhe vlerësimi i tyre i bëhet i njohur studentëve nëpërmjet pedagogut dhe sekretarisë mësimore të degës përkatëse. Studentët raportuan se njoftohen për pikët e provimit nga pedagogu i lëndës, sistemi Pitagora ose nga sekretaria mësimore. Këtë procedurë e konfirmoi dhe stafi akademik. Evidenca: - Evidenca 40 Nderfaqe sistemi PITAGORA. - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, neni 87 i Rregullores së Njesisë kryesore. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 25 orëve nga shpallja e rezultateve, neni 92 i Rregullores së Njesisë kryesore. Stafi akademik raportoi se ka procedurë për ankimimin e një note por asnjë nga ata nuk kishte patur një çështje të tillë pasi deri tani, çdo problematikë ishte mbyllur në nivel Departamenti. Studentët raportuan se janë në dijeni për procedurën e kontestimit të një

	note, në rast se ata nuk janë dakord. Një prej studentëve raportoi se ka ankimuar notën dhe se u morr në pyetje nga pedagogu i lëndës. Evidenca: - Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mami"; - Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas nenit 92 i Rregullores së Njesisë kryesore, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet pasi ka kaluar nga përgjegjësi i departamentit, dërgohet te Dekani i Fakultetit, i cili ngre një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjese edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda 24 orëve nga dita e depozitimit të ankesës Evidenca: - Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - 156 Formular Vlerësimi i performances se stafit akademik.			
Konkluzione	Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit provimi përfundimtar (70%), provimi të ndërmjetëm (15%), aktivizimi (10%) dhe frekuentimi (5%). UMT ka marrëveshje me CleanScore për zbatim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora ose në klasë. Institucioni ka marrëveshje me Akademia për përdorimin një sistem antiplagjaturë me pagesë. Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Pë rmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Ky program studimi është hartuar për t'u ofruar studentëve edukim të thelluar dhe aftësim profesional e shkencor në fushën mami. Përmbajtja e programit është ndërtuar në mënyrë të tillë që të ofrojë njohuri të thelluar teorike ashtu edhe praktike në përmbajtje të lëndëve. Programi është hartuar dhe përditësuar në mënyrë të tillë për t'i pajisur studentët me njohuri të avancuara në tema të specializuara në studimet e kësaj fushe, ndërsa synon të përmirësojë aftësitë praktike, të ofrojë mjaftueshëm fokus teorik si dhe të ketë në qendër punën e thelluar kërkimore që ndihmon studentët e interesuar që të ndjekin programet e ciklit pasardhës sic është programi i doktoraturës. Për sa i përket perspektivës së karrierës, studentët që përfundojnë me sukses programin marrin suportin e nevojshëm nga Zyra e Karrierës për t'u njohur me intitucione që ofrojnë pozicione të kësaj fushe. Prandaj, synimet themelore të programit mund të përmbledhen si më poshtë: Të prodhojë profesioniste mami. Evidencat: - Evidenca 1 Statuti i UMT; - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 21 Rregullore programi Mami . - Evidenca 91Plani mesimor Mami
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Pothuaj të gjitha procedurat e përfitimit të imazheve mjekësore tashmë realizohen nga pajisjet mjekësore të integruara me teknologjinë e informacionit, për këtë arsye, përmbajtja e programit është oreintuar drejt përdorimit të saj në lëndë apo module të ndryshme. Studentët në të gjithë programet e studimit në FSHMT, përfshirë dhe këtë program studimi, janë nga studentët me mesatare dhe përgatitjen më të mirë në treg. Evidencat: - Evidenca 21 Rregullore programi Mami . - Evidenca 91Plani mesimor Mami
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen	Në fund të lëndës, pedagogët informojnë dhe orientojnë studentët për çështjet më të rëndësishme. Stafi akademik raportoi se zhvillon konsultime me studentët në orën e fundit të lëndës.

në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. <i>Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron se pikë të fortë.</i> Studentët raportuan se zhvillojnë konsultime me pedagogët. Evidenca: - Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik ushtron të drejtën e organizimit e mësimdhënies në përputhje me objektivat që ka programi i studimit. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. angazhimi i personelit akademik paralelisht në shërbimet spitalore, është avantazh mjaft i madh për studentët pasi sjellin eksperiencën e tyre me raste konkrete të cilat diskutohen dhe interpretohen. Angazhimi i studentëve në raste konkrete rrit besimin e studentëve duke zhvilluar më tej aftësitë profesionale të tyre. Studentët nëpërmjet personelit akademik, angazhohen në studimet e tyre duke marrë pjesë edhe në prezantime në konferenca brenda dhe jashtë vendit. Eksperiencia në këto forma të ndërveprimit të studentëve, ka rritur bashkëpunimin dhe mobilitetin e studentëve në institucionet brenda dhe jashtë vendit. Evidencat: - Evidenca 13.1 Ditar praktike Mami. - Evidenca 13.2 Ditar i praktikës profesionale Mami. - Evidenca 18 Konferenca vjetore libri i abstrakteve FSHMT. - Evidenca 30 Konferenca vjetore 2023 FSHMT ne bashkepunim me UV dhe UISH. - Evidenca 167 Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore UMT - Evidenca 166 Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të	Në varësi të fushës së veprimtarisë, personeli akademik organizon aktivitete ku përfshihen edhe studentët. Ndërkohë evente të

reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	ndryshme që zhvillohen në FSHMT, studentët marrin pjesë në mënyrë interaktive. Gjithashtu konferenca dhe ëorkshope janë organizuar në FSHMT dhe studentët marrin pjesë në mënyrë interaktive. Evidencat: - Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve knonferenca e shkencave mjekesore; - Evidenca 18 Konferenca vjetore libri i abstrakteve FSHMT. - Evidenca 19. Aktiviteti dt 14 Nentor 2023 në FSHMT;			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. Por në këtë program studimi studentët janë më të fokusuar në praktikë dhe në zbatimin e teorive tek pacientët, pavarësisht se Institucioni i krijon mundësitë dhe angazhon ato në kërkim shkencor. Evidencat: - Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mesimore shkencore ne UMT - Evidenca 182 Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Botimeve UMT VSA nr.42 datë 29.04.2022;			
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional në Mami garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron si pikë të fortë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet t pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedure të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në nivel institucional, aktet rregullatore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kanë parashikuar në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit të studentëve në tërësi dhe ata të ciklit të dytë të studimeve. Edhe Rregullorja e Fakultetit shpreh qartë të gjithë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në FSHMT. Ndërkohë për çdo program studimi, institucioni ka hartuar rregulloret e posaçme në të cilat pasqyrohen specifikat që çdo program ka në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të diplomimit. Në programin e studimit MP. Mami sikundër është përmendur edhe më lart, realizohet me provim me shkrim. Studenti ka në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe realizimin e tij. Evidencat: - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 5 Rregullore e FSHMT; - Evidenca 21 Rregullore progami Mami
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Për studentët që i nënshtrohen provimit final, fakulteti dhe departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të testimit dhe vlerësimit. Në shërbim të studentëve vihen në dispozicion informacione, udhëzime, materialet e nevojshme në funksion të provimit final ose temës së diplomës. Për çdo lëndë/modul të zhvilluar, departamentet mbledhin pyetje që lidhen me përmbajtjen e lëndës / modulit të zhvilluar. Më pas nga një fond i caktuar pyetjesh zgjidhen pyetjet për provimin final. Evidencat: - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 5 Rregullore e FSHMT; - Evidenca 21 Rregullore progami Mami
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni ad-hoc i ngritur në përbërje të tre departamenteve, ka përgjegjësin e realizimit dhe mbarëvajtjes të të gjithë procesit të provimit, ankimimit dhe shpalljes së rezultateve. Paraprakisht studentët janë udhëzuar lidhur me përmbajtjen e provimit nëpërmjet koordinatorit të programit dhe sekretarisë së departamentit. Përmbledhje e temave nga lëndët e zhvilluara gjatë studimeve akademike, formate pyetjesh, u vihen në dispozicion studentëve. ndërkohë bazuar në kërkesën e studentëve,

	departamenti organizon ore konsultimi/ përmbledhje në lëndë të ndryshme ku studentët kanë vështirësi. Evidencat: - Evidenca 5 Rregullore e FSHMT; - Evidenca 21 Rregullore progami Mami . - Evidenca 63; 64; 65. Procedure per monitorimin dhe verifikimin e dokumentacionit te provimeve. - Evidenca 164 Rregullore e sekretarise mesimore;
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në programin e studimit MP. Mami nuk është parashikuar temë diplome.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Mbrojtja e diplomës në programet master profesional është me provim final.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i provimit është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit përfundimtar. Korigjimi i provimit kryhet i pa ckoduar dhe në përfundim të korigjimit, sekretaria përpilon rezultatet. Korigjimi në rastet e provimit me alternativa korigjohet në mënyrë të automatizuar nga Clean score. Në përfundim të procesit të korigjimit, ankimimit dhe sqarimeve, studenti vlerësohet me noten përfundimtare. Evidencat: - Evidenca 21 Rregullore progami Mami . - Evidenca 65 Procedure per monitorimin dhe verifikimin e dokumentacionit te provimeve. - Evidenca 145. Relacion clean score.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria	Studenti konsiderohet se ka përfunduar studimet nëse ka shlyer të gjitha detyrimet akademike e financiare përkundrejt institucionit. Në rregulloren e UMT dhe të FSHMT janë

përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	përcaktuar modalitetet dhe detyrimet që duhen përmbushur për diplomimin e studentit. Studenti pajiset me diplomën e programit të studimit MP Mami, suplementin e diplomes dhe kopje te programit të studimit të zhvilluar gjatë studimeve të tij. Evidencat: - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 5 Rregullore e FSHMT; - Evidenca 22 Format diplome bachelor mami - Evidenca 22. 1 Suplement diplome 2020-2023.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumenti themelor për studentët është Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matrikulimi deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emetimin e certifikatave dhe diplomave. Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen, pas diplomimit, në arkivin e institucionit dhe më pas dorëzohen në Arkiven e Shtetit Shqiptar. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen ndërsa institucioni ruan kopje e njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike. Evidencat: - Evidenca 2 Rregullore e UMT; - Evidenca 32 Sherbimet per studentetkerkesaFSHMT. - Evidenca 33 Sherbimet per studentetFSHMT. - Evidenca 34Pranimet dhe Regjistrimet UMT.			
Konkluzione	Procesi i diplomimit realizohet me anë të provimit përfundimtar të diplomes. Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Provimi përfundimtar përfshinë tematika nga i gjithë viti i studimit. Studentët kanë mundësi të përdorin kapacitetet dhe infrastrukturën për arsye kërkimore. Në përfundim të provimit të përgjithshëm ose të punimit të diplomës, studentët vlerësohen me notë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Departamentet në FSHMT përgjegjëse për programin e studimit MP ne Mami, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.. Në FSHMT ka një infrastrukturë të pasur laboratorike e cila u vjen në ndihmë jo vetëm studentëve të programit por edhe të programeve të tjera. Laboratori mami / infermieri janë në funksion të studentëve për simulimin e rasteve të ndryshme të shqyrtuara në pjesën teorike të lëndëve Evidencat: - Evidenca 117 Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet - UMT. - Evidenca 118Infrastruktura ne funksion te mesimdhënies, Universiteti i Mjekesise, Tirane
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Një nga pikat më të forta që ka UMT dhe FSHMT, është ekzistenca e rrjetit spitalor universitar në vend. 5 spitalet universitare që janë pjesë e UMT garantojnë realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. Studentët kanë mundësi të aplikojnë njohuritë e tyre në praktikë në këto qendra sipas specifikës dhe shërbimit. Evidencat: - Evidenca 13.1 Ditar praktike Mami. - Evidenca 13.2 Ditar i praktikës profesionale Mami. - Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare.
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me	Cdo orë e praktikës profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve në programin e studimit, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në formën e shlyerjes së praktiëks klinike. Ky informacion është mjaft i nevojshëm për studentët në dokumentimin e aftësimit të tyre profesional. Nisur nga shkalla e

mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Iartë e punësimit të studentëve brenda dhe jashtë vendit, rezulton se raportet teori/praktikë rezultojnë të jenë në nivelin e duhur. Evidencat: - Evidenca 13.1 Ditar praktike Mami. - Evidenca 13.2 Ditar i praktikës profesionale Mami - Evidenca 6 Rregullore Departamenti.			
Konkluzione	Me qëllim formimin e studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Në bazë të akteve ligjore, Spitalet Universitare janë në funksion të formimit të specialistëve të shëndetësisë, përfshirë ketu dhe programin MP në Mami. Kjo gjë garanton formim të mirë profesional të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit,	Personeli akademik me kohë të plotë dhe më kohë të pjesëshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit MP “Mami” plotëson të gjitha kërkesat që lidhen me detyrimet ligjore. I gjithë personeli përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi plotësojnë kriteret e përcaktuar në LAL sipas kategorive Profesor, Lektor dhe Asistent lektor dhe në përputhje me aktet e brendshme të UMT. DLKIPISBP ka rekrutuar 85 mbikqyrës së praktikës

drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	profesionale (mentorë) dhe ka tre laborantë (dy me Msc dhe një me Dr). Në këtë program studimi angazhohen në total: - Viti akademik 2022-2023: 7 PAE (0 Prof. Dr, 3 Prof. As., 3 Dr, 1 proces Dr) dhe 6 PAK (0 Prof. As., 4 Dr, 2 Msc); - Viti akademik 2021-2022: 7 PAE (0 Prof. Dr, 3 Prof. As., 3 Dr, 1 proces Dr) dhe 5 PAK (0 Prof. As., 3 Dr, 2 Msc); - Viti akademik 2020-2021 7 PAE (0 Prof. Dr, 3 Prof. As., 3 Dr, 1 proces Dr) dhe 5 PAK (0 Prof. As., 3 Dr, 2 Msc); Personeli akademik me kohë të pjesshme mbulon kryesisht lëndët specifike ose është pjesë e personelit që zhvillon ose mbështet praktikat profesionale në mjediset e strukturave spitalore universistare ose jashtë tyre. Evidenca: - Evidenca 97 Tabelat me statistikat permbledhese (Anekset_ASCAL) - Evidenca 97.2 Tabela permbledhes Ascal Mami - Evidenca 158 Model kontrate personel ndihmes akademik - Evidenca 159 Model kontrate pedagoget e jashtem - Evidenca 160 Model kontrate personel akademik - Takimi me Dekanin, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Departamenti përmbush të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore të organizimit dhe infrastrukturës akademike për realizimin me sukses të këtij programi përfshirë gradat, titujt dhe ngarkesat akademike. Nga evidencat GVJ konstatoi se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në masën 56% dhe në masën 44% mbulohet nga personel shëndetësor i strukturave spitalore universistare (profesionitë të shëndetësisë). Numri i personelit akademik me kohë të plotë është i qëndrueshëm në vite, gjithashtu dhe kualifikimi i tyre me Grada dhe Tituj duke e konsideruar si pikë të fortë të këtij programi. Personeli mjekësor i strukturave shëndetësore universistare spitalore dhe jospitalore (kryesisht i dy materniteteve, siptale universistare) është personel potencial i i kualifikuar dhe specializuar në fushën e shkencave mjekësore për UMT-në. Ky

	personel përfshihet në procesin e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, të zhvillimit të praktikave mësimore/klinike-diagnostike, të shërbimeve për mbështetje dhe zhvillim të UMT-së, mbikëqyrje klinike-diagnostike për studentët, si dhe veprimtari të tjera, sipas përcaktimeve të rregulloreve specifike (referuar nenit 17, 18 të Statutit të UMT-së). Evidenca: - Evidenca 7 Organigrama Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, - Evidenca 86 Programi MP. Mami 2020-2022 - Evidenca 86.1 Programi MP. Mami 2021-2023 - Evidenca 86.2 Programi MP. Mami 2022-2025 - Evidenca 92 Syllabuset e lendeve MP. Mami - Evidenca 93 Tabela e personelit akademik te angazhuar ne programin MP Mami - Evidenca 96 CV-te e personelit akademik te angazhuar ne MP.Mami, - Evidenca 97.2 Tabela permbledhes Ascal MSc Mami - Evidenca 97 Tabela Anex ASCAL Plan mesimor MP Mami - Takimi me Dekanin, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ka një qëndrueshmëri të konsiderueshme. Shumica e stafit ka minimalisht mbi 5 vjet në FSHMT. Personeli akademik i FSHMT dhe ai i angazhuar në programin e studimit, përbën një nga pikat më të forta të veprimtarisë akademike të FSHMT. Shumica prej personelit akademik kanë nisur karrierën e tyre në këtë fakultet dhe kanë avancuar në karrierën e tyre falë politikave mbështetëse të institucionit për promovimin e personelit akademik. Kjo mbështetje ka krijuar tek personeli një klimë pozitive e cila reflektohet në qëndrueshmërinë afatgjatë të personelit akademik. Evidenca: - Evidenca 97 Tabelat me statistikat permbledhese (Anekset ASCAL),

	- Evidenca 97.2 Tabelat me statistikat permbledhese (Anekset_ASCAL) MP Mami, - Evidenca 160 Model kontrate personel akademik - Takimi me stafin akademik
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	UMT/FSHMT ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. GVJ verifikoi me sondazh dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë, që rezultoi të ishin të plota në përputhje me procedurat dhe kërkesat përkatëse. Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UMT. Nga verifikimi u pa se dosjet e personelit ishin të plotësuar korrekt. Dosjet e pedagogëve ishin të azhurnuara me punimet e tyre. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë, - Evidenca 96 CV-te e personelit akademik të angazhuar në MPMami - Evidenca 162 Procedurat e punësimit të personelit akademik, ndihmes administrativ UMT - Evidenca 163 Praktikë e punësimit të personelit akademik në UMT - Takimi me perfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga evidencat rezultojnë se për këtë program studimi janë të angazhuar tre personel ndihmës akademik ka të cilat dy janë me Msc dhe një me Dr. Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentohet angazhimi i personelit ndihmës akademik, asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirëmbajtjen e laboratoreve. Personeli ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij. Evidenca:

	- Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 97.2 Tabelat me statistikat përmbledhëse (Anekset ASCAL) MP Mami, - Evidenca 165 Të dhëna statistikore për personelin akademik PAE, PAK, administrativ UMT - EVIDENCA 165.2 Personeli akademik 2021-2022 - Takimi me Dekanin, përgjegjësit e departamenteve - Vizita në institucion.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UMT/FSHMT, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “MP në Mami”. Pranë zyrës së Burimeve Njerëzore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër si dhe dosjet personale për staf jo akademik. Dosjet e pedagogëve ishin të azhurnuara me punimet e tyre në revista apo konferenca dhe me trajnimet apo ëorkshopen e realizuara nga stafi. Nga verifikimi i GVJ u pa se dosjet e personelit nuk kishin mangësi në plotësimin e tyre. Këto të dhëna shërbejnë më pas për analiza, raporte të ndryshme që kryhen institucioni në kuadër të vlerësimit të performancës dhe vetëvlerësimit për procese të ndryshme. <i>Pavarësisht kësaj, GVJ sugjeron që nga sektori përkatës të shihet mundësia e unifikimit të formatit të CV të stafit akademik.</i> Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekesise, Tiranë - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2023 - Evidenca 83 Analize vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analize vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analize vjetore viti akademik 2021,DLKIPISBP

	- Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT - Evidenca 155 Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ - Evidenca 156 Shembull Vlerësimi i performancës së stafit akademik - Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe stafin akademik
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UMT realizon praktikat profesionale në qendrat spitalore universitare në bazë të akteve ligjore dhe janë përgjegjëse për mbështjen e realizimit të këtyre praktikave. FSHMT angazhon personel mbikëqyrës së praktikave profesionale nga qendrat spitalore universitare dhe jo vetëm, që janë përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e praktikës profesionale. FSHMT ka angazhuar 68 mbikëqyrës së praktikave profesionale, të cilët ndjekin dhe vlerësojnë studentët. Praktikat lëndore zhvillohen në laboratorët e institucionit FSHMT, dhe <i>GVJ nga vizita në institucion evidentoi se këto laboratore plotësojnë më së miri kushte për një zhvillim dhe realizim normal të praktikave lëndore.</i> Evidenca: - Evidenca 48 Shembull marrëveshje bashkëpunimi me IAL ndërkombëtare - Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera - Evidenca 83 Analize vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analize vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analize vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 101 Lista e bashkëpunimeve me institucione të tjera_FSHMT - Evidenca 101.1.Shembull e zhvillimit të praktikave në institucione të tjera_FSHMT - Evidenca E 4 Grafiku i praktikave Programi Bachelor Mami, Viti akademik 23-24. - Evidenca 13.1 Shembull Ditari i praktike Infermieri+mami - Evidenca 13.2 Shembull Ditar praktike Mami 2

	- Evidenca 13.3 Shembull Ditari praktike Mami 3 - Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore - Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjësit e departamenteve dhe stafin mbikqyrës në praktika profesionale.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	UMT, QSUT dhe qendra të tjera spitalore universitare, sipas akteve ligjore, ofrojnë ambjente të përshtatshme për realizimin e praktikave profesionale. Mes UMT-së dhe këtyre institucioneve si: QSUNT, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, SUT, Spitali USM, Materniteti “Koço Gliozheni”, Materniteti “Mbretëresha Geraldinë”, Spitali Memorial, kanë marrëveshje bashkëpunimi për pritjen e studentëve për realizimin e praktikave profesionale. Në Rregulloren e programit të studimit, praktikat vlerësohen nga pedagogu i lëndës përkatëse sëbashku me mbikëqyrës së praktikave profesionale. Evidenca: - Evidenca 13.1 Shembull Ditari i praktike infermieri+mami - Evidenca 13.2 Shembull Ditar praktike Mami 2 - Evidenca 13.3 Shembull Ditari praktike Mami 3 - Evidenca 92 Syllabuset e lëndëve MP Mami - Evidenca 93. Tabela e personelit akademik të angazhuar në programin MP Mami - Evidenca 96 CV-te e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit - Evidenca 97.2 Tablelat me statistikat përmbledhese (Anekset_ASCAL) - Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjësit e departamenteve dhe stafin mbikqyrës në praktika profesionale.
Konkluzione	Departamenti përgjigjës për programin e studimit MP në “Mami” plotëson kriteret ligjore lidhur me Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit. Rekrutimii stafit akademik realizohet sipas legjislacionit në fuqi dhe urdhrave të brendshëm të UMT. Institucioni ka një data baza për stafin akademik, administrativ dhe ndihmës mësimorë. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore për realizimin e praktikës profesionale. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale studentët mbikqyren nga

	stafi akademik dhe përfaqësues i institucionit ku kryhet praktika. GVJ konstatoi se janë present marrëveshjet dypalëshe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në institucion u vërejt se mjediset mësimore janë të madhësive të ndryshme në përshtatje me natyrën e procesit mësimor që zhvillohet në to. GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapësirat e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj. Hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e leksioneve në Poëer Point. Evidenca: - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 119 Lista e aseteve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë - Vizita në institucion - Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Sekretarisë mësimore - Vizita në bibliotekë dhe në ambjentet e FSHMT-së. - Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjësit e departamenteve.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të	UMT/FSHMT disponon ambjente të mjaftueshme për leksionet, seminarët, praktikat e laboreve mësimore. Sallat mësimore janë të gjitha të pajisura me mjetet e nevojshme audiovizive dhe

pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	didaktike (PC, projektorë, internet, mikrofonë, tabela etj.). Sallat laboratorike janë të bollshme dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillin normal të mëimit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Nga evidencat dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se Fakulteti disponon 2 godina qëndrore ku zhvillon veprimtarinë e vet kryesore përveç mjedisëve të tjera të UMT dhe QSUT. Godina 1 ka 6 auditorë, 10 salla seminari, 4 laboratorë, 15 zyra administrative. Godina 2 ka 11 auditorë, 14 salla seminari, 3 laboratorë dhe 21 zyra administrative. Evidenca: - Evidenca 117 Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet - UMT - Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 119 Lista e aseteve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë - Vizita në institucion - Takimi me studentët dhe me stafin akademik.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë në përdorim 7 laboratorë infermierisë, laborator i imazherisë digjitale dhe laborator i anatomisë radiologjike. Nga vizita në institucion dhe evidencat GVJ konstaton se FSHMT, në partneritet me projektin HAP ka 2 laboratorë modernë për infermieristikën. Këta laboratorë përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në Mami. Evidenca: - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 117 Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet - UMT - Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë




	- Evidenca 119 Lista e asetëve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë - Vizita në institucion - Takimi me studentët dhe me stafin akademik
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	UMT/FSHMT ka në përdorim për studentët 8 salla informatike me një kapacitet prej 200 kompjuterash. Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe me stafin akademik GJV konstatoi se FSHMT ka laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. Në të gjitha ambjentet akademike e administrative ka mbulim me internet për përdorim nga stafi akademik, sekretaria mësimore dhe studentët. Evidenca: - Evidenca 38 Shembull Propozim projekti –staf - Evidenca 117 Lista e laboratoreve didaktike në të 3 Fakultetet - UMT - Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 119 Lista e asetëve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë - Vizita në institucion - Takimi me studentët dhe me stafin akademik
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe	UMT/FSHMT disponon ambjente dhe kapacitetet e mjaftueshme për praktikat e labororet mësimore. Vetë UMT zotëron kapacitete salla, laboratore klinike për realizimin e këtyre praktikave. Gjithashtu UMT/FSHMT ka siguruar mjedise të mjaftueshme, të posaçme dhe të përshtatshme nëpërmjet marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang programesh studimi për praktikat profesionale, me institucionet e tjera shtetërore. UMT/FSHMT ka marrëveshje bashkëpunimi për pritjen e studentëve për realizimin e praktikave profesionale me: QSUNT, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, SUT, Spitali USM, Materniteti “Koco Gliozheni”, Materniteti “Mbretresha Geraldine”, Spitali Memorial. (Tabela 5. evidenca 97.2). Evidenca:

ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	- Evidenca 38 Shembull Propozim projekti –staf - Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione të tjera - Evidenca 97.2 Tabela përmbledhse (Anekset-Ascal) - Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mesimdhënie, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. - Vizita në institucion - Takimi me studentët dhe me stafin akademik			
Konkluzione	Institucioni siguron Infrastrukturën e nevojshme si mjediset mësimore/auditorë, laboratorët mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. FSHMT zotëron laboratorët mësimor në funksion të programit të studimit Mami. Në funksion të programit të studimit në MP në Mami janë 8 salla informatike me një kapacitet prej 200 kompjuterash. UMT/FSHMT ka siguruar mjedise të mjaftueshme, të posaçme dhe të përshtatshme nëpërmjet marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang programesh studimi për praktikat profesionale, me institucionet e tjera shtetërore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mesimdhënie dhe mjediset mbështetëse të mesimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të	Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Biblioteka është e pajisur me poste interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mesimdhënie dhe mesimnxënies. Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe vizita në institucion, bibliotekë u konstatua se nga FSHMT ofrohet literatura bazë dhe

parashikuara në programin e studimit.	ndihmëse e cila vihet në dispozicion të studentëve (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit e cila përditësohet nga titullarët e lëndëve. Studentët referojnë se kanë cikle leksionesh të shkruara/përshtatura, të përditësuara si dhe në formë. Evidenca: - Evidenca 23 Shembull_nderfaqe_Googleclassroom - Evidenca 42 Nderfaqe EasyËeb (për lëndën) - Evidenca 113 Biblioteka FSHMT - Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe pershkrim - Evidenca 115 Komunikimi zyrtar per U-Library - Evidenca 148 Përshkrim funksionaliteteve të platformës EasyËeb LMS - Evidenca 150 Permbledhje Manuale EasyËeb - Takimi me studentët dhe stafin akademik - Vizita në institucion, bibliotekë.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	UMT/FSHMT pasuron bibliotekën me literaturë të fundit me libra për mjekësinë në infermierinë. Literatura e të gjitha moduleve dhe burimet e paraqitur në syllabus aprovohet në fillim të vitit akademik nga njësia bazë. Një kopje e syllabusit i dërgohet Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Nga takimi me Zyrën e Kurrikulave u tha që kishin bërë disa herë kërkesë për përditësim të programeve të lëndëve, por nuk kemi një evidencë për këtë. <i>Nga takimi i GVJ me stafin akademik, stafi pranon se e përditëson literaturën, ndërkohë që nga shqyrtimi i evidencave ku janë prezantuar sillabuset, rezulton se për disa lënde nuk kanë e kanë literaturën e përditësuar të viteve të fundit.</i> Nga ana tjetër stafi akademik referon se për tekstet mësimore si dhe artikujt në revistën shkencore të UMT dhe të fakulteteve është këshilli botues i UMT-së i cili shqyrton, diskuton dhe miraton botimet e personelit akademik. Botimet shkencore të publikuara në revistat shkencore janë të publikuara në faqen e internetit të institucionit dhe të fakulteteve respektive. Personeli akademik dhe studentët e UMT botojnë pa kosto në revistat shkencore të universitetit. Evidenca:

	- Evidenca 11 Praktikë për miratimin e planeve mësimore - Evidenca 11.1 Praktikë për propozim ndryshimesh në planet mësimore viti akademik 22-23 - Evidenca 92 Syllabuset e lëndëve MP Mami - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Kurrikuave dhe NJSBC
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka është në dispozicion të stafit dhe studentëve në mënyrë të barabartë në të gjitha programet dhe ciklet e studimit. Biblioteka ka një rregullore të brendëshme që respektohet me seriozitet për sa i përket mënyrës së tërheqjes, shfrytëzimit dhe trajtimit të librave. Nuk ka asnjë kufizim të shfrytëzimit të librave në bibliotekë që lidhet me programin apo fushën e studimit. Studentët mund të shfrytëzojnë gjithë fondin e bibliotekës, pavarësisht nga fusha që studiojnë. Nga vizita në institucion biblioteka është funksionale dhe ka të depozituara disertacionet, botimet shkencore dhe tekstet mësimore të personelit akademik të institucionit. Doktoratave të mbrojtura në UMT, u dedikohet një hapësirë në faqen elektronike zyrtare të universitetit, si dhe ishin të depozituara nga një kopje. Fondi i bibliotekës mbulon kryesisht fushat e shkencave mjekësore, të shëndetit publik, stomatologjike, farmaceutike dhe të shkencave teknike mjekësore, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës u vërejt prani e studentëve në sallën e leximit dhe pranë kompjuterëve të sallës, të cilët shfrytëzonin bibliotekën online dhe tekset mësimore. Ambjent i përshtatshëm, i qetë, me dritë dhe me ngrohje. Evidenca: - Evidenca 10 Revista shkencore e FSHMT 2022-2023 - Evidenca 24 Udhëzues biblioteka online - Evidenca 70 Lista e publikimeve të miratuara nga Këshilli i botimeve - Evidenca 113 Biblioteka FSHMT - Evidenca 152 Lista e botimeve të revistës shkencore të FSHMT - Evidenca 182 Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Botimeve-UMT-VSA-nr. 42-datë-29.04.2022 - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	UMT/FSHMT ka në dispozicion të studentëve 53,000 libra dhe revista shkencore 18,000 koleksione si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Në bibliotekën e institucionit ka literaturë të mjaftueshme që pasurohet në mënyrë periodike me botime (revista shkencore, libra, etj). Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave dhe informatizimi i saj është i pasuruar me informacion të gjerë mbi materialin në brendësi të librit. Nga takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e FSHMT-së GVJ konstatoi se studentët dhe stafi përdorin si librat hard-copy në bibliotekë si dhe bibliotekën online. (https://ulibrary.rash.al/). Evidenca: - Evidenca 113 Biblioteka FSHMT - Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe përshkrim - Evidenca 115 Komunikimi zyrtar për U-Library - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët. - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët GVJ konstatoi se FSHMT ka për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online si biblioteka "Hinari", U-library, Telemedicine, Albanian Health foundation, AGORA, OARE, ARDI, GOALI, EBSCO Discovery,service (EDS) (Ëithout OPAC), Up todate. (Tab 17 evidenca 97.2) Nga vizita në bibliotekën e FSHMT-së u vërejt prania e studentëve në sallën e bibliotekës duke shfrytëzuar kryesisht bibliotekën online. Evidenca: - Evidenca 24 Udhëzues biblioteka online - Evidenca 97.2. Tabela permbledhse Ascal - Evidenca 113 Biblioteka FSHMT - Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe përshkrim - Evidenca 115 Komunikimi zyrtar për U-Library

	- Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së - http://hinarilogin.research4life.org - www.telemedicine.al/index.php/components/virtual-electronic - www.albanianhealthfund.org/missions/medical-library
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e FSHMT-së, GVJ konstatoi se biblioteka e FSHMT është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Fondi i bibliotekës mbulon kryesisht fushat e shkencave mjekësore dhe të shkencave teknike mjekësore, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Gjithashtu, kjo bibliotekë ofron mundësi shfrytëzimi të sallës së leximit dhe kompjuterave. Evidenca: - Evidenca 113 Biblioteka FSHMT - Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe përshkrim - Evidenca 115 Komunikimi zyrtar për U-Library - Evidenca 146 Shërbimet e Telemjekësisë - Takimi me stafin akademik, studentët - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e FSHMT-se është e konceptuar të ketë një sallë studimi me pajisje kompjuterike (kompjuter, videoprojektor) që krijon mundësinë për të punuar në mënyrë individuale apo edhe në grup. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimi (8.00 - 18.00). Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e FSHMT-së GVJ konstatoi se ambienti i bibliotekës, sallës së leximit përdoret nga studentët jo vetëm për lexim por edhe për organizimin e takimeve studentore. Evidenca: - Evidenca 24 Udhëzues biblioteka online - Evidenca 113 Biblioteka FSHMT - Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe përshkrim - Takimi me stafin akademik, studentët. - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së

Kriteri 8.Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e FSHMT-së GVJ konstatoi se çdo hyrje dhe dalje në bibliotekë dokumentohet në kartelat e stafit dhe studentëve ku shënohet titulli i librit, autori, viti i botimit si dhe koha e marrjes dhe dorëzimit të librave. Stafi akademik orioenton studentët për shfrytëzimin e librave duke u kërkuar atyre me rigorozitet përgatitjen e detyrave të kursit dhe duke evidentuar literaturën e shfrytëzuar. Siç dhe parashikohet në Statutin e UMT-së neni nr.110 mbi funksionimin e bibliotekës, duke u nisur nga kërkesat e stafit akademik dhe studentëve, mbi bazën e propozimeve të departamenteve të FSHMT bëhet kërkesa për pasurimin me tituj të ri. Kjo kërkesë i drejtohet administratorit të fakultetit. Nga dokumentat e dorëzuara, kërkesa e fundit për pasurimin e bibliotekës ishte viti 2018. Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë e justifikuan këtë për shkak të librave on-line. Në takimin me studentët, ata raportuan se e frekuentojnë bibliotekën. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë - Evidenca 52 Praktikë për miratimin e buxhetit vjetor UMT - Evidenca 53 Procedura për miratimin e buxhetit vjetor - Evidenca 53.1 Propozim për miratimin e buxhetit vjetor - Evidenca 54 Proçedura e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm - Evidenca 88 Të dhëna Fianciare për alokim buxheti FSHMT (3 vite) - Evidenca 90 Te dhena per zhvillimin e infrastruktures dhe investimet - Takimi me stafin akademik, studentët. - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së
Konkluzione	UMT/FSHMT ka një Bibliotekë Universitare që kanë hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. UMT/FSHMT ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. Oraret e shërbimit të bibliotekës janë tek rregullore e bibliotekës, oraret janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Literatura mjekësore në bibliotekë është e pasur dhe e azhornuar.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Që nga momenti i regjistrimit online në UAlbania të studentëve dhe pajisjen e tyre me numrin unik nga RASH, të dhënat pasqyrohen në sistemin e Pitagorës të UMT nga sekretaria mësimore ku edhe pasqyrohet aktiviteti i studentit gjatë gjithë kohës së studimit. GVJ konstatoi se Easy-Ëeb është platforma kryesore e institucionit me funksione të shumëfishta në administrimin e aktivitetit akademik, mësimor dhe trajnues. Evidenca: - Evidenca 40 Ndërfaqe sistemi PITAGORA - Evidenca 41 Ndërfaqe_UMED google education - Evidenca 42 Ndërfaqe EasyËeb (për lëndën) - Evidenca 143 Ndërfaqe ëeb UMT - Evidenca 149 Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA - Evidenca 150 Përmbledhje Manuale EasyËeb - Evidenca 151 Marrëveshje me RASH për shërbime në fushën e IT - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët. - Vizita në sekretarinë mësimore
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit	Prej vitit akademik 2021-2022, UMT ka kaluar në sistemin e ri Pitagora të sekretarisë mësimore ku përveç shërbimeve të sekretarisë mësimore mundësohet edhe administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Musliu

79

akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Në sistemin e brendshëm gjithashtu hidhen të dhënat e të gjithë stafit të angazhuar në varësi të njësive kryesore, bazë dhe statusit të punësimit (Burimet njerëzore). Një tjetër sistem informatik që UMT përdor si rezultat i bashkëpunimit dhe partneritetit në projekte është Sistemi i regjistrimit të të diplomuarve pas përfundimit të studimit “GRADUA” me koordinatör kryesor Universiteti Bujqësor i Tiranës. Evidenca: - Evidenca 40 Ndërfaqe sistemi PITAGORA - Evidenca 43 Ndërfaqe_Sistem elektronik i dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikantëve - Evidenca 132 Procedura dhe praktika e pikëzimit dhe renditjes së aplikantëve në prog. e ciklit I dhe të integruar - Evidenca 141 Ndërfaqe ASCAL - Vizita në sekretarinë mësimore - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, studentët. - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Studentët e UMT informohen për gjithçka nëpërmjet platformës elektronike Pitagora, që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike dhe jo vetëm. Gjithashtu në këtë platformë studentët regjistrohen online për provime në sesionet jo të rregullta të provimeve (vjeshtë, mbartje etj.) Çdo student dhe anëtar i stafit akademik apo administrativ, përmes adresës elektronike që disponon, ka akses në këtë sistem. Për stafin akademik dhe administrativ përdoret email (emër.mbiemër@umed.edu.al), për studentët (emër.mbiemër@student.umed.edu.al). Funksionalitetet kryesore të përfshira në platformën e re Pitagora, janë: Zona Didaktike (struktura akademike, menaxhimi i karrierës së studentit, provime dhe tema e diplomës), Zona Administrative (pranimi dhe regjistrimi, orari dhe provimet, menaxhimi i studentëve), Tarifatat (menaxhimi i tarifave të studimit, bursa për

	studentët, periudha financiare), Diplomimi (provimet e Shtetit, praktika studentore, diploma online dhe suplementi). Evidenca: - Evidenca 40 Ndërfaqe sistemi PITAGORA - Evidenca 43 Ndërfaqe_Sistem elektronik i dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikantëve - Evidenca 132 Procedura dhe praktika e pikëzimit dhe renditjes së aplikantëve në prog. e ciklit I dhe të integruar - Evidenca 141 Ndërfaqe ASCAL - Evidenca 149 Pershkrim i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, studentët. - Vizita në bibliotekën e FSHMT-së - Takimi me Zyrën e sekretarë mësimore
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. UMT përdor platformën UMT-Easy Eëb për edukimin në distancë jo vetëm për procesin akademik por edhe për informimin e studentëve dhe zhvillimin e veprimtarive të tjera si takime, mbledhje, ëëbinar, prezantime, diskutime etj. Në sistem, nëpërmjet një portali të posaçëm, studentët informohen jo vetëm me njoftimet për procesin mësimor por edhe për veprimtari të tjera apo informacione të nevojshme që lidhen me kërkimin shkencor, aktivitetet studentore, mobilitetet etj. Të dhënat në lidhje me veprimtaritë, leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund të kryejnë nëpërmjet UMT-Easy Eëb. Gjithashtu UMT ka në përdorim platformat e libraritë online, "E-Research", "Training4ALL", "Virtual university", "U-Library". E-UMT, e-book Akademik collection (koleksioni i librave elektronike), Health Source: Academic&Nursing Edition,, (evidenca 97.2. tabela 17) Nëpërmjet bashkëpunimit me QSHA, institucioni realizon procesin e aplikimit online të kandidatëve (maturantëve) në programet e UMT, matrikullimin e studentëve bazuar në të dhënat

	e detajuara të përcjella nga UMT, menaxhon dhe monitoron procesin e provimit të shtetit ose licencimit, koordinon të dhënat e studentëve aktualë dhe të rinj për krijimin e regjistrit elektronik themeltar, sipas udhëzimeve të MAS, ose përditësohen numrat e matrikullimit në bazën e të dhënave së agjencisë së provimeve. Evidenca: - Evidenca 41 Ndërfaqe_UMED google education - Evidenca 97.2. Tabela permbledhëse Ascal - Evidenca 142 Pr.sc të shërbimeve të RASH - Evidenca 151 Marrëveshje me RASH per sherbime ne fushen e IT - Takimi me pergjegjesit e departamenteve, stafin akademik, studentët - Vizita në Sekretarinë mësimore e FSHMT-së
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	UMT-Easy ëeb është një sistem është ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë akses, përdorim, informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuenton. Zyra e IT mirëmban, ndjek dhe raporton në kohë reale për titullarët e institucionit duke gjeneruar raporte të ndryshme statistikore. Sistemi ka ndërfaqe shqip dhe anglisht dhe është i aksesueshëm edhe në versionin mobile. Ndërkohë, Pitagora është një program i sekretarisë mësimore ku mund të hyjë sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Nëpërmjet faqes zyrtare, pasqyrohet veprimtaria administrative, institucionale, zgjedhjet, programin e transparencës, akademike, kulturore e sociale Për komunikim të brendshëm, përveç sistemeve të sipërcituara, stafi përdor e-mailët zyrtarë të institucionit, google classroom, googlesite, googlemeet pa limit për personelin akademik dhe studentët e institucionit. Ndërkohë personeli akademik përdor edhe faqe personale interenti nën domain-nin e unversiteti falë shërbimit Google education.

	FSHMT me anë të sistemit Pitagora jep informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuentonte. Falë Zyrës së IT bëhej e mundur mirëmbajtja e sistemit duke bërë të mundur përdorimin në çdo kohë. Evidenca: - Evidenca 23 Shembull _ndërfaqe_Googleclassroom - Evidenca 41 Ndërfaqe _UMED google education - Evidenca 147 Pershkrim i funksionaliteteve te platformes E-UMT - Evidenca 148 Pershkrim funksionaliteteve te platformes EasyEeb LMS - Evidenca 149 Pershkrim i funksionaliteteve te sistemit PITAGORA - Evidenca 150 Permbledhje Manuale EasyEeb - Vizita në Sekretarinë mësimore e FSHMT-së - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët - Takimi me përfaqësuesit Zyrës së burimeve njerëzore
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të UMT-së që është aktive në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, e cila përditësohet periodikisht me aktivitetin e fakultetit, departamenteve. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit. FSHMT zotëron një faqe ëeb aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe jep informacione të ndryshme. Evidenca: - Evidenca 12 Ndërfaqe Facebook _FSHMT - Evidenca 168 Ndërfaqja e internetit FSHMT - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët. - Vizita në Sekretarinë mësimore e FSHMT-së
Konkluzione	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Çdo student ka flogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion

	për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Sistemi ka të përfshirë edhe komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve. Faqja zyrtare e UMT/FSHMT është aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5


Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në UMT/FSHMT, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. Në hartimin e buxhetit merren parasysh të ardhurat e gjeneruara nga institucioni nga studentët, shërbimet, projektet etj. Politikat e shpërndarjes së burimeve financiare dhe përdorimi i tyre kryhet në përputhje me nevojat që kanë njësitë përbërëse të institucionit. Plani i financimit ka përshkruar të gjitha kostot e programit të studimit që përfshijnë burimet njerëzore dhe infrastrukturore, materialet e konsumit, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimit të bibliotekës, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm. Nga shqyrtimi i evidencave GJV konstaton praninë e raportit financiar të kostove të njësisë bazë për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi për një cikël të plotë studimi. Evidenca: - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023

	- Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore 2021 DLKIPISBP - Evidenca 110 Analizë vjetore zyra e financës - Evidenca 111 Analizë vjetore Zyra e burimeve njerëzore - Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT - Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.
Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Proçesi i hartimit të planit financiar nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësia bazë dhe strukturat administrative të fakultetit. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Në këto të dhëna financiare të FSHMT-së për alokim buxheti janë parashikuar financimi i burimeve njerëzore, pagat, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e saj, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja, bursat e studentave, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 52 Praktike për miratimin e buxhetit vjetor UMT - Evidenca 53 Procedura për miratimin e buxhetit vjetor - Evidenca 54 Procedura e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në përfundim të vitit kalenderik hartohen pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e biznesit dhe masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar. Institucioni kryen analiza periodike dhe harton raporte vjetore. Raportin e auditimit, në të cilin paraqiten rezultatet paraprake të auditimit të kryer në institucion dhe i vihet në dispozicion titullarit të tij. Bordi i administrimit dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Të gjitha të dhënat, analizohen nga organet drejtuese të UMT, Bordi i Administrimit dhe Senati akademik, evidentohen problematikat në politikat e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të proçesit akademik. GVJ nga evidencat konstaton se FSHMT kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij nëpërmjet Njesisë së Auditit të Brendshëm [NjAB], dhe gjithashtu, përdor dhe instrumente të tjerë të jashtëm (audit i jashtëm) për procesin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit, për përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm. Evidenca: - Evidenca 50 Praktika e ndjekur për auditim nga njësi audituese e jashtëmne (UNICEF) - Evidenca 51 Praktika e ndjekur për auditim nga Njësia e Auditit të Brendshëm - Evidenca 169 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMTmaj 2022 - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP
---	--

	- Evidenca 88 Të dhëna Fianciare për alokim buxheti FSHMT (3 vite) - Evidenca 110 Analizë vjetore zyra e financës - Evidenca 111 Analizë vjetore Zyra e burimeve njerëzore - Evidenca E.7 Praktikë e auditit të brendshëm në FSHMT - Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nga shqyrtimi evidencave, takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, dhe NJSBC, konstaton se monitorimi i ecures së veprimtarive akademike të UMT/FSHMT, kontrolli, auditimi dhe raportimi është i vazhdueshëm nëpërmjet raportit vjetor i cili hartohet në zbatim të nenit të LAL 80/2015. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Pjesë e këtij informimi janë edhe partnerët e jashtëm të institucionit, ministritë e linjës, QSHA, ASCAL etj. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 88 Të dhëna Fianciare për alokim buxheti FSHMT (3 vite) - Evidenca 110 Analizë vjetore zyra e financës - Evidenca 111 Analizë vjetore Zyra e burimeve njerëzore - Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e	UMT/FSHMT garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që

programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	siguron nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Nga takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC dhe shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se FSHMT dëshmon qëndrueshmëri financiare, mirëmenaxhon të ardhurat dhe kontributet financiare me efikasitet dhe transparencë në zhvillimin e infrastrukturës e logjistikës në funksion të mësimdhënies, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor. Evidenca: - Evidenca 53 Procedura për miratimin e buxhetit vjetor - Evidenca 53.1 Propozim për miratimin e buxhetit vjetor - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 88 Të dhëna Financiare për alokim buxheti FSHMT (3 vite) - Evidenca 110 Analizë vjetore zyra e financës - Evidenca 111 Analizë vjetore Zyra e burimeve njerëzore - Evidenca 110 Analizë vjetore zyra e financës - Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.
Konkluzione	Çdo vit akademik UMT/FSHMT harton raportin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Fondet burojnë nga ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nisur nga evidencat, takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC dhe vizita në ambientet e FSHMT-së GVJ konstaton se institucioni (senati dhe bordi administrimit) harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Po ashtu departamenti, FSHMT, Senati, bordi administrimit Rektorati, harton dhe raporton për efektet financiare që ka hapja e një programi të ri në FSHMT duke u siguruar që të mbulojnë ciklin e plotë akademik. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së departamentit, Koordinator i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit dhe praktikave profesionale. Paralelisht, ai informon drejtuesin e departamentit për problematikat e ndryshme. Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore-FSHMT - Evidenca 34 Pranimet dhe Regjistrimet në UMT - Evidenca 21 Rregullore fshmt_Program cikli i dyte Master Profesional - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 73 Shembull_VBA per miratimin e efekteve financiare te hapjes se nje programi - Evidenca 75 Vendim i perbashket Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit per veprimtarine e UMT - Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 119 Lista e aseteve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë - Evidenca 133 Pr. Sc Publikimi i kriterëve të pranimit-ciklit i parë dhe PICD - Evidenca 135 Praktikë për miratimin e kriterëve të pranimit cikli i parë dhe integruar - Evidenca 137 Praktikë për miratimine kuotave cikli i parë dhe integruar - Evidenca 138 Raporti i grupit te punes per verifikimin e kapaciteteve pritese 23-24 - Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC. - Vizita në ambientet e FSHMT-së
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UMT/FSHMT ndjek politika dhe procedura si dhe ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVJ vuri re se FSHMT bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, nr. 80/2015, statutin e UMT siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për tu regjistruar në Programin e Studimit Master Profesional në “Mami”. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme.

	Evidenca: - <i>Eviencia 1 Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë.</i> - <i>Eviencia 5 Rregullore-FSHMT</i> - <i>Evidenca 16 Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studenteve. FSHMT</i> - <i>Evidenca 21 Rregullore_fshmt_Program cikli i dyte Master Profesional</i> - <i>Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami</i> - <i>Evidenca 34 Pranimet dhe Regjistrimet në UMT</i> - <i>Evidenca 39 Njoftim per thirrje mobiliteti</i> - <i>Evidenca 124 Lista e aktiviteteve Keshilli Studentor UMT</i> - <i>Eviencia 130 Politika dhe praktika per fitimin e bursave te studenteve dhe perjashtimi nga tarifa vjetore e studimit</i> - <i>Evidenca 133 Pr. Sc Publikimi i kriterëve të pranimit-ciklit i parë dhe PICD</i> - <i>Eviencia 134 Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, II, III (SPA)</i> - <i>Eviencia 135 Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar</i> - <i>Evidenca 137 Praktikë për miratimine kuotave cikli i parë dhe integruar</i> - <i>Evidenca 139 Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT</i> - <i>Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ në takimin me stafin akademik dhe studentet, si dhe dokumentat e vena në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen “ditët e informimit të maturantëve”. Modalitet e pranimit në të gjitha programet e studimit përcaktohen me vendim senati në mbështetje të kriterëve kombëtare të përcaktuara në LAL dhe propozimeve të njësisë bazë për kriterë të veçanta. Kriteret shpallen dhe u bëhen të ditur të gjithë aplikantëve gjatë periudhës së informimit dhe gjithashtu publikohen në UAlbania. Institucioni bashkëpunom gjatë gjithë kohës me QSHA për përdorimin e sistemit në kohë reale. Programi MP në “Mami” ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Në planifikim e kuotave të pranimit parashikohen edhe kuota për studentë nga trojet. Neni 4 i

	Statutit së Institucionit raporton se në programet e studimit pranoen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Kriteret e pranimiit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati Akademik. Evidenca: - <i>Eviencia 1 Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë.</i> - <i>Eviencia 5 Rregullore-FSHMT</i> - <i>Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT</i> - <i>Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami</i> - <i>Evidenca 34 Pranimet dhe Regjistrimet në UMT</i> - <i>Evidenca 133 Pr. Sc Publikimi i kriterëve të pranimit-ciklit i parë dhe PICD</i> - <i>Eviencia 134.Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, II, III (SPA)</i> - <i>Eviencia 135 Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar</i> - <i>Evidenca 136 Praktikë për miratimine kuotave cikli i parë dhe integruar</i> - <i>Evidenca 139 Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT</i> - <i>Evidenca 143 Ndërfaqe ëeb UMT.</i> - <i>Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore</i> - <i>Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC, Sekretarinë Mësimore.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni gjithashtu planifikon kuota për transferim të studimeve nga insitucione të tjera dhe programe të dyta studimi. Kushtet dhe procedura e transferimit të krediteve gjithashtu janë të kuptueshme dhe u bëhen të ditur aplikantëve nga stafi dhe sekretaria mësimore. Neni 46; 47: 48 i Rregullores së Departamentit përmend Njohjen dhe Ekuivalentimin e studimeve, diplomave dhe kalimin nga një program studimi në një tjetër. Në rregulloren e programit të studimit neni 10 përcakton kriteret e regjistrimit. Neni 31 dhe 32 i Rregullores së Njësisë Kryesore përcakton shkëputjen dhe ndërprerjen e studimeve. Në Raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe gjatë takimeve, u theksua se procedura e transferimet në institucionet e arsimit të

	lartë rregullohet me udhëzim të posaçëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. FSHMT çdo vit akademik përcakton kriteret e pranimi si mesatarja dhe programet nga mund të transferohen me njohje të plotë ose të pjesshme të krediteve të transferimit. Në evidencat e DVV është paraqitur një set dokumentesh të transferimit dhe shembull procedure transferimi. GVJ konstaton se pranimi i transferimit të studentëve në programin e studimit bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UMT dhe Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 6 Rregullore Departamenti - Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 34 Pranimet dhe Regjistrimet në UMT - Evidenca 98 Tabela me statistikat e studentëve - Evidenca 98.1 Statistika student FSHMT - Evidenca 109 Analize vjetore Sekretaria mesimore - Evidenca 135 Praktikë për miratimin e kriterëve të pranimi cikli i parë dhe integruar - Evidenca 136 Praktikë për miratimin kuotave cikli i parë dhe integruar - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Para fillimit të vitit akademik Institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Institucioni prej vitesh merr pjesë në Panairët Eork & Study të organizuar në rrethe dhe në Tiranë në afatet e përcaktuara nga MAS sipas një kalendari të shpallur paraprakisht, me përfaqësues nga zyra e Informimit dhe Njësitë akademike. Informacion të bollshëm ka dhe në katalogun e universitetit, faqe zyrtare e UMT, rrjete të komunikimit social si profili në Facebook/Meta, llogaria në Instagram, numra telefoni në dispozicion, si dhe vë në dispozicion të studentëve materiale informuese si broshura, fletëpalosje duke informuar studentët kandidatë rreth programeve që ofron. <i>Ajo që vërehet si nga dokumentacioni dhe nga takimi me stafin konstatohet se për këtë</i>

	<i>master nuk ka pasur regjistrime për vitet e fundit. Kjo ka ardhur për disa faktorë të jashtëm kryesisht: e para studentët marrin të drejtën e ushtrimit të profesionit sapo mbarojnë programin Bachelor dhe së dyti një student që përfundon Master profesional në mami nuk ka motivim në pagë (referuar sistemit të pagave në sektorin shëndetësor publik), si ndodh për një të diplomuar në Msc. Megjithatë stafi akademik gjatë takimit, referoi se ndërkohë po punon me studentët e programit Bachelor dega Mami për të nxitur promovimin e këtij programi, duke mundësuar që për vitin akademik 2024-2025 të synojnë shtojnë nr e studentëve të regjistruar në MP Mami.</i> Evidenca: - Evidenca 12 Ndërfaqe Facebook_FSHMT - Evidenca 68 Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular - Evidenca 98 Tabela me statistikat e studentëve - Evidenca 98.1 Statistika student FSHMT - Evidenca 123 Shembull Broshurë Informuese për studentët FSHMT - Evidenca 128 Orientimi dhe informimii maturantëve FSHMT - Evidenca 143 Ndërfaqe ëeb UMT - Evidenca 168 Ndërfaqja e internetit FSHMT - (https://fshmt.edu.al/) - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UMT/FSHMT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. UMT/FSHMT ndjek një politikë të barabartë pranimi për të gjithë kandidatët qofshin këta me aftësi të veçanta apo përkatësi të ndryshme (studentë romë ballkano egjiptian, studentët me statusin e jetimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë). Kriteret që janë vendosur për këtë kategori janë të njëjta me ato të publikuara nga Ministria e Arsimit në udhëzimin nr.17, datë 30.07.2019. GVJ konstatoi se infrastruktura e FSHMT, e vënë në dispozicion, është përshtatshme për t'u aksesuar si me këmbë ashtu edhe me

	mjete ndihmëse si rampa, ashensorë etj. për studentët me aftësi ndryshe. Në këtë mënyrë sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta Evidenca: - Evidenca 97.2 Tablelat me statistikat permbledhese (Anekset_ASCAL) - Evidenca 98 Tabela me statistikat e studentëve - Evidenca 98.1 Statistika student FSHMT - Evidenca 34 Pranimet dhe Regjistrimet në UMT - Evidenca 130 Politika dhe praktika per fitimin e bursave te studenteve dhe perjashtimi nga tarifa vjetore e studimit - Evidenca 133 Pr. Sc Publikimi i kriterëve të pranimit-ciklit i parë dhe PICD - Evidenca 134 Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, II, III (SPA) - Evidenca 135 Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar - Evidenca 137 Praktikë për miratimine kuotave cikli i parë dhe integruar - Evidenca 139 Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT - Evidenca 143 Ndërfaqe ëeb UMT. - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UMT/FSHMT planifikon dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera (nga trojet shqipfolëse). Këto kriteret të miratuara me vendim Senati Akademik sipas udhëzimeve të Ministrisë, më pas i dërgohen zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe për dijeni QSHA. Neni 4 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 108 i rregullores së Institucionit UMT përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njësisë Kryesore, në nenet 35 dhe 36 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. Mobiliteti është i mundur

	në kuadër të këtij programi studimi dhe u raportua nga Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë si dhe nga studentët. FSHMT nëpërmjet faqes Eeb, fletë palosjeve, reklamave televizive, Zyrës së karrierës dhe këshillimit, ofron informacion për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 98 Tabela me statistikat e studentëve - Evidenca 98.1 Statistika student FSHMT - Evidenca 110 Analizë vjetore zyra e financës - Evidenca 123 Shembull_Broshure Informuese - fshmt - Evidenca 128 Orientimi dhe informimi i maturanteve - Evidenca 129 Grupi i punës për informimin e maturanteve - Evidenca 130 Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studentëve dhe përjashtimi nga tarifa vjetore e studimit - Evidenca 135 Praktikë për miratimin e kriterëve të pranimit cikli i parë dhe integruar - Evidenca 137 Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UMT/FSHMT ndjek politikë mbështetëse për studentët me aftësi të ndryshe, studentët me një prind, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, studentë romë dhe ballkano-egjiptian duke i ndihmuar si nga ana ekonomike ashtu dhe për integrimin sa më të mirë të tyre në rastet kur ata e dëshmojnë këtë përkatësi. Për studentët me nevoja dhe statuset e veçanta institucioni ofron lehtësira financiare (bursa studimi), të cilat parashikohen në kontratat individuale të cilat rimbursohen nga buxheti i shtetit për llogari të UMT, pas depozitimit të kërkesës në departamentin përkatës. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT

	- Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 89 Të dhëna për bursat e studentëve FSHMT (3 vite) - Evidenca 130 Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studentëve dhe përjashtimi nga tarifa vjetore e studimit - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.			
Konkluzione	UMT/FSHMT ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit bazuar në aktet ligjore. UMT, ndjek politikë mbështetëse për studentët romë dhe ballkano-egjiptian duke i ndihmuar si nga ana ekonomike dhe studentët me nevoja dhe statuse të veçanta institucioni ofron lehtësira financiare të cilat parashikohen në kontratat individuale. Vitet e fundit nuk ka pasur rregjistrime në këtë program. Ndërkohë stafi akademik po punon me studentët e programit bachelor mami për të promovuar këtë program me synim shtimin e nr në vitin e ardhshëm akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të ëeb si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga zyra e karrierës, përgjegjësi i programit të studimit dhe tutori i vitit përkatës në lidhje me

	regulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj. Informacioni zyrtar në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin përfshihen në sistemin e menaxhimit të universitetit. Evidenca: - Evidenca 5 Rregullore-FSHMT - Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 92 Syllabuset e lëndëve MP Mami - Evidenca 107 Manuali i keshillimit të karrierës FSHMT - Evidenca 108 Aktivitete të Zyres së Karrierës FSHMT - Evidenca 108.1 Raport Aktiviteti i zyrës së karrierës - Evidenca 120 Te dhena për Alumni nga Udherat profesionale - Evidenca 128 Orientimi dhe informimi i maturanteve - Evidenca 129 Grupi i punës për informimin e maturanteve - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mesimore - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se FSHMT përmes Zyrës së Sekretarisë Mësimore ofron informacion dhe udhëzime të hollësishme për studentët mbi procedurat, në bazë të kushteve të njohjes dhe transferimit të krediteve. Studentëve i bëhet e ditur se procedurës së ekuivalentimit i nënshtrohen studentët që kanë mbaruar apo kryer pjesërisht programe universitare me orientim mjekësor me module të ekuivalentuara nga komisioni përkates i ngritur nga UMT/FSHMT. Neni 46; 47; 48 i Rregullores së Departamentit përmend njohjen dhe Ekuivalentimin e studimeve, diplomave dhe kalimin nga një program studimi në një tjetër. Në rregulloren e programit të studimit neni 10 përcakton kriteret e regjistrimit. Procedura e transferimi nuk është e detajuar/specifikuar. Neni 31 dhe 32 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton shkëputjen dhe ndërprerjen e studimeve. Kriteret e pranimit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati Akademik. Evidenca: - Evidenca 5 Rregullore FSHMT

	- Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 98 Tabela me statistikat e studentëve - Evidenca 98.1 Statistika student FSHMT - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimi, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Vlerësimi zhvillohet në bazë të nenit 88 të Rregullores së institucionit, nenit 16 të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe nenit 17 të Rregullores së Programit të studimit. Në këto nene raportohen kriteret dhe mënyrat e tesimit dhe vlerësimit të dijeve. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Evidenca: - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 6 Rregullore Departamenti - Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 92 Syllabuset e lëndëve MSc. Mami - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Përgjegjësi i programit informon studentët për procedurat e diplomimit në fillim të shkollës në mënyrë që ata të përgatiten. Në dokumentat rregullatorë përshkruhen dy mënyra për mbrojtjen e diplomës. Në këtë program studimi është parashikuar mbrojtje diplome me temë për diplomimin e studentëve. Procesi i diplomimit realizohet me anë të mbrojtjes së mikrotezës. Në rregulloren e FSHMT shpjegohet i gjithë procesi i diplomimit të studentit. Gjithashtu ka dhe një udhëzues për strukturën e temës së diplomës. Neni 26, pika 3 e Rregullores së FSHMT, thotë se

Mollevu!

[Signature]

	FSHMT brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, u bën të njohur studentëve temat e diplomave. Dekanati i FSHMT përcakton procedurat që duhet të ndiqen për informimin e studentëve. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 6 Rregullore Departamenti _DDRSHIKIOGJ - Evidenca 9 Udhëzues për hartimin e temës së diplomë. - Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 86 Programi MP Mami 2020-2022 - Evidenca 86.1 Programi MP Mami 2021-2023 - Evidenca 86.2 Programi MP Mami 2022-2025 - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e kurrikulës.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe stafi akademik, GVJ konstatoi se studentët dhe gjithë të interesuarit kanë mundësi të marrin informacion për programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjegjësit të programit në çdo ditë të vitit dhe vecanërisht në muajin shtator gjatë periudhës së informimit. Në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panairët ëork & Study të organizuara nga MAS dhe duke organizuar ditët e hapura për maturantët. Evidenca: - Evidenca 86 Programi MP. Mami 2020-2021 - Evidenca 86.1 Programi MP Mami 2021-2022 - Evidenca 86.2 Programi MP. Mami 2022-2023 - Evidenca 128 Orientimi dhe informimi i maturantëve FSHMT - Evidenca 129 Grupi i punës për informimin e maturantëve - Evidenca 133 Pr. Sc Publikimi i kriterëve të pranimit-ciklit i parë dhe PICD - Evidenca 134 Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, I (SPA)


	- Evidenca 139 Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, zyrën e kurrikulës, NJSBC-së.			
Konkluzione	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedrëne vlerësimit të dijeve, kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UMT Informon publikun për programet e studimit që ofron duke organizuar takime të hapura me të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit, fletë palosjeve informuese, informacionit në faqen e ëebit të universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përgjegjësi i programit u jep studentëve gjithë informacionin e detajuar për organizimin e procesit mësimor, kalendarin akademik ku përfshihen datat e fillimit dhe mbarimit të procesit mësimor, periudhat e teorisë dhe praktikës, sesionet e provimeve dhe mbrojtja e diplomës. Nga takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe evidencat GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit në mënyra të ndryshme siç janë e-maillet, takimet në Zyrën e Karrieres, stafin akademik, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit, ose përmes faqes zyrtare http://umed.edu.al , si dhe mund të aksesojnë në

	formatin hardcopy dosjen e programit të studimit pranë zyrave të shërbimit të studentëve pranë UMT. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ - Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 143 Ndërfaqe ëeb UMT - Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: FSHMT informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Master Profesional në “Mami”. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet ëeb-it. Po ashtu në orën e parë studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodin lëndor, raporti leksion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj. Ky informacion akcesohet dhe përmes faqes zyrtare të UMT http://fshmt.edu.al. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ - Evidenca 21 Rregullore për programet MP FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 86 Programi MP. Mami 2020-2021 - Evidenca 86.1 Programi MP. Mami 2021-2022 - Evidenca 86.3 Programi MP Mami 2022-2023 - Evidenca 92 Syllabuset e lëndëve MP. Mami - Evidenca 168 Ndërfaqja e internetit FSHMT

	- <i>Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, zyrene kurrikulave</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e karrieres, NJSBC, zyrën e Kurrikulave GVJ konstaton se institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës nëpërmjet funksionimit të Zyrës së karrierës, duke ju ardhur në ndihmë të gjithë studentëve që vazhdojnë dhe që kanë përfunduar studimet në UMT/FSHMT, për të arritur potencialin e tyre maksimal dhe për tu mirëorientuar në tregun e punës. Zyra e karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale si dhe për t'i njoftuar me mundësi punësimi dhe aktivitete të edukimit në vazhdim që organizohen nga UMT si Panairin e Punës. Evidenca: - <i>Evidenca 107 Manuali i karrierës së studentëve FSHMT</i> - <i>Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës</i> - <i>Evidenca 108.1 Raport mbi Aktivitetet e zyrës së karrierës FSHMT</i> - <i>Evidenca 120 Te dhena për Alumni nga Udherat profesionale</i> - <i>Evidenca 123 Shembull Broshure Informuese për studentët FSHMT</i> - <i>Evidenca 124 Lista e aktiviteteve Këshilli Studentor UMT_FSHMT</i> - <i>Evidenca 125 Përberja e Këshillit Studentor UMT</i> - <i>Evidenca 126 Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT</i> - <i>Evidenca 127 Statuti i Këshillit Studentor UMT</i> - <i>Evidenca 128 Orientimi dhe informimi i maturanteve</i> - <i>Evidenca 129 Grupi i punës për informimin e maturanteve</i> - <i>Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e karrieres, NJSBC, Kurrikulave.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjerësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programmit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitale. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij në fillim të çdo viti akademik. Ky informacion vihet në dispozicion dhe nëpërmjet platformës UMT Easy ëeb, Pitagora, e-maileve. Evidenca: - Evidenca 40 Ndërfaqe sistemi PITAGORA - Evidenca 128 Orientimi dhe informimii maturantëve FSHMT - Evidenca 148 Përshkrim funksionaliteteve të platformës EasyËeb LMS - Evidenca 149 Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA - Evidenca 150 Përmbledhje Manuale EasyËeb. - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që studentët e UMT/FSHMT informohen për të gjitha nëpërmjet platformës elektronike (Pitagora) që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin cdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike. Në këtë sistem ata futen nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit. Ky akses në platformën Pitagora është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë, nga çdo ambient ku mund të ndodhen. Evidenca: - Evidenca 40 Ndërfaqe sistemi PITAGORA - Evidenca 149 Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC.
Konkluzione	UMT/FSHMT dhe programi i studimit i siguron infrastrukturën e nevojshme studentëve për marrjen e informacionit të hollësishëm lidhur me organizimin e programit të studimit, duke filluar nga

	organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale, literaturën e nevojshme dhe strukturat ndihmëse. Institucioni mundëson përfshirjen e studenteve në një sërë aktivitete informuese në lidhje me kërkesat e punëdhënësve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore mban informacion në lidhje me studentët e regjistruar dhe të diplomuar në të gjitha programet e studimit. Informacioni mbahet sipas udhëzimeve të MAS dhe në koordinim me QSHA në formë fizike dhe elektronike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, zyrën e sekretarisë mësimore, GVJ konstaton se FSHMT disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Këto të dhëna (statistika të përgjithshme për numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, studentët e diplomuar dhe të dhënat e punësimit të tyre) mblidhen, përditësohen dhe analizohen nga departamenti, Sekretaria Mësimore, Drejtoria e kurrikulave, Zyra e Karrierës dhe Alumni. Evidenca: - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës - Evidenca 109 Analizë vjetore Sekretaria mësimore

	- Evidenca 120 Të dhëna për Alumni nga Udhërat profesionale - Takimi me pergjegjesit e departamentit, stafin akademik, studentet, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrieres, NJSBC.									
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	FSHMT ruan në regjistrat fizikë dhe elektronikë gjithë dokumentacionin vjetor për regjistrimin, ngrirjen e studimeve dhe largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Ky informacion është i ruajtur në kohë reale në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore si dhe në dosjen e secilit student në sekretari, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it apo QSHA-së. GVJ takimi në zyrën e sekretarisë mësimore konsaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Regjistruar</th> <th>Diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>18</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>18</td> <td>17</td> </tr> </tbody> </table> Evidenca: - Evidence 79 Raporti Vjetor_UMT_2020-202 - Evidence 79.1 Raporti Vjetor_UMT_2021-2022 - Evidence 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidence 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidence 82 Raporti vjetor FSHMT 2023 - Evidenca 83 Analize vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidence 84 Analize vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidence 85 Analize vjetore viti akademik 2021 DLKIPISBP - Evidence 97.2 Tabela permbledhese Ascal MP Mami - Evidenca 98 Tabela me statistikat e studentëve - Evidenca 98.1 Statistika student FSHMT - Evidenca 109 Analizë vjetore Sekretaria mësimore - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore	Viti akademik	Regjistruar	Diplomuar	2020-2021	18	17	Totali	18	17
Viti akademik	Regjistruar	Diplomuar								
2020-2021	18	17								
Totali	18	17								

	- <i>Takimi me zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore disponon të gjithë dokumentacionin e duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. Ky informacion është në formë fizike me nënshkrimet e personave sipas karakteristikës së dokumentit dhe i ruajtur elektronikisht në sistemin e brendshëm ku secili person i autorizuar ka akses të kufizuar në bazë të pozicionit të punës. Nga takimi me sekretarinë dhe bazuar në rregulloren e sekretarisë GVJ konstaton se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga stafi akademik, sekretaria mësimore dhe vetë studenti në llogarinë e tij. Evidenca: - <i>Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë</i> - <i>Evidenca 40 Nderfaqe sistemi PITAGORA</i> - <i>Evidenca 149 Pershkrim i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA</i> - <i>Evidenca 151 Marrëveshje me RASH për shërbime në fushën e IT</i> - <i>Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore</i> - <i>Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Puna e sekretarisë mësimore është në monitorim të vazhdueshëm nga administratori i institucionit në kuadër të hierarkisë dhe mbikqyrjes. Nga auditimi i GVJ u vërejt që në regjistrat dhe procesverbale ku janë të vendosura notat nuk kishte korigjime. Nga takimi me studentët ata shprehen se janë të kënaqur nga puna e zyrës së sekretarisë mësimore, respektimi i orareve dhe korrektësia e punës nga punonjësit e sekretarisë. GVJ konstaton korrektësi dhe seriozitet në punën e sekretarisë. Evidenca: - <i>Evidenca 3 Organigrama UMT</i> - <i>Evidenca 51 Praktika e ndjekur për auditim nga Njësia e Auditit të Brendshëm</i> - <i>Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021</i> - <i>Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022</i>

Shkollari

[Signature]

	- Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Evidenca 109 Analize vjetore sekretaria mesimore - Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mesimore.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim. Njësia bazë harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u vu re se në vitin akademik 2020-2021 janë regjistruar 18 studentë. Nga takimi me stafin akademik dhe shqyrtimi evidencave të raporteve dhe analizës vjetore të FSHMT-së GVI konstatoi se për 2 vite akademike 2021-2022 dhe 2022-2023 nuk u hap programi MP Mami. Nisur nga kjo dukuri stafi akademik referon se është punuar me studentët e programit Bachelor dega Mami, duke mundësuar që për vitin akademik 2023-2024 të rihapej programi MP Mami. Sipas të dhënave të dokumentuara pranë UMT- së për Alumni nga Udhërat profesionale (UISH) rezulton që ushtrojnë profesionin e mamisë: - për vitin 2017 - 115 vetë; - për vitin 2018 - 86 vetë; - për vitin 2019 - 81 vetë; - për vitin 2020 - 56 vetë; - për vitin 2021 - 30 vetë. Nga të dhënat e ofruara vërejmë se punësimi i studentëve që janë diplomuar në vitin 2021, rezultojnë të jenë punësuar mbi 97% e tyre. Evidenca: - Evidenca 66 Analizë statistikore e të dhënave të kandidatëve që kanë aplikuar UMT 2021-2022

	- Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 97.2 Tabela permbledhse Ascal MSc Mami - Evidenca 98 Tabela me statistikat e studentëve - Evidenca 98.1 Statistika student FSHMT - Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës - Evidenca 109 Analize vjetore sekretaria mesimore - Evidenca 120 Të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale - Evidenca 137 Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar - Evidenca 139 Procedura për miratimin e kritereve dhe kuotave të pranimit në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT - Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mesimore, Zyra e Karrierës.			
Konkluzione	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Institucioni garanton të dhëna statistikore të studentëve që menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta. GVJ konstaton korrektësi dhe seriozitet në punën e sekretarisë. Njësia bazë ku realizohet programi i studimit harton raporte analitike, periodike/analiza vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin si dhe punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit nga RVB, GVJ konsaton se studentët përfshihen dhe angazhohen në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Sipas parashikimeve ligjore, Senati Akademik i UMT, ka në përbërjen e vet dhe student, neni 25, pika 3 Statuti i UMT. Paralelisht, Institucioni ka ngritur dhe Këshillin studentor. Studentët janë dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme që Institucioni ngre (përfshirë këtu edhe procesin e akreditimit). Gjithashtu ekziston senatori i klasës i cili bën urën lidhëse midis studentëve dhe strukturave dhe funksiononte më së miri. Këto u konfirmuan edhe në takimin e zhvilluar me studentët. Nga ana tjetër, raportuan se kanë gjithnjë një derë të hapur nga Drejtuesia e Njësive Kryesore në rast se kanë problematika të ndryshme. Studentët raportuan se janë thirrur nga Drejtuesi i Departamentit dhe kanë dhënë mendimin e tyre për organizimin e konferencës. Vlerësimi i stafit akademik nga studentët është diçka pozitive. Në nenin nr. 36, nr. 117 dhe nr. 129 të statutit të UMT-së është e parashikuar që 1 student i Këshillit Studentor (i ekselencë) të jetë pjesë e NJSBC dhe në këshillin e etikës. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 5 Rregullore UMT - Evidenca 125 Përberja e Këshillit Studentor UMT - Evidenca RVB BACHELOR MAMI_i firmosur - Evidenca Mendimi i dekanit MAMI - Evidenca 69 Përberja e NJSBC - VSA nr.103, dt.20.10.2020 Per miratimin e NJSBC ne UMT - Evidenca 102 Urdher per ngritjen e GVB

	- Evidenca 124 Lista e aktiviteteve Keshilli Studentor UMT_FSHMT - Evidenca 126 Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT - Evidenca 127 Statuti i Këshillit Studentor UMT - Evidenca 169 Raporti i Vleresimit te Brendshem Institucional_UMT_maj 2022 - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT - Takimi me studentët dhe stafin akademik
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se FSHMT përdor sistemin vlerësimit të performancës së stafit akademik, pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave bëhet nga NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësive bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Studentët konfirmuan që vlersojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. Gjithashtu departamenti përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe kordinatorit të programit të studimit. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konsaton se studentët janë pjesë e disa komisioneve në të cilën japin kontributin e tyre (Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshilli i Etikës, Unioni Studentor, Grupit të RVB). Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 14 Shembull formulari i performances 2023 - Evidenca 27 Pyetësi i studenteve_fshmt_23 - Evidenca 28 Rezultatet_pyetësorit_studentet_23




	- Evidenca 67 Shembull_Pyetesor_Vleresim i studenteve per lendet e programit te studimit_formular - Evidenca 68 Shembull_Pyetesor_Vleresim i studenteve per UMT_formular - Evidenca 126 Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT - Evidenca 127 Statuti i Këshillit Studentor UMT - Evidenca 156 Formular raporti per realizimin e veprimtarise akademike - Evidenca E 2.1 Plan masash për zhvillimin e procesit mësimor 20-21 - Evidenca E 2.2 Urdhër i MAS, nr 395, 10062021. - Evidenca E 2.3 Vendim i Senatit për vitin akademik 22-22, në kushtet e pandemisë - Takimi me studentët, stafin akademik.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në statutin e UMT-së zëri dhe përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohej me pjesëmarrjen e tyre në organe dhe komisione të rëndësishme si NJSBC, GVB, RVB, Senat Akademik etj. Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët, njëri për lëndën dhe tjeri për institucionin. Kjo është një procedurë standarde që UMT përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithshme informohen për rezultatet. Studentët konfirmuan që vlersojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe shqyrtimi i dokumnetacionit, GVJ konstaton se studentët ndjehen të përfaqësuar dhe se Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament apo me pyetësorë. Evidenca: - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 11.1 Praktikë për propozim ndryshimesh në planet mësimore viti akademik 22-23 - Evidenca 27 Pyetësori i studenteve_fshmt_23 - Evidenca 28 Rezultatet_pyetësorit_studentet_23

Shkollari

[Signature]

	- Evidenca 67 Shembull_Pyetesor_Vleresim i studenteve per lendet e programit te studimit_formular - Evidenca 68 Shembull_Pyetesor_Vleresim i studenteve per UMT_formular - Evidenca 124 Lista e aktiviteve Keshilli Studentor UMT_FSHMT - Evidenca 125 Përberja e Këshillit Studentor UMT - Evidenca 130 Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studentëve dhe përjashtimi nga tarifa vjetore e studimit - Evidenca 145 Relacion cleanscore. - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me studentët, stafin akademik.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë të përshkruara të drejtat e tyre në dokumentat rregullatorë dhe ato respektohen me rigorozitet nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. UMT ka marrëveshje me CleanScore për zbatim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit. Me qëllim vlerësimi të jetë i drejtë dhe i pa anshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Departamenti pas procesit të ankimimit ngrenjë komision rivlerësimi të ndryshëm nga komisioni i parë, i cili ben rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije. Evidenca: - Evidenca 6. Rregullore Departamenti

	- Evidenca 21 Rregullore për Progam MP në FSHMT - Evidenca 21.1 Rregullore për Progam MP Mami - Evidenca 31 Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve - Evidenca 61 Procedurë ankimi i studentit për vlerësimin - Evidenca 92 Syllabuset e lëndëve MP Mami - Takimi me studentët, stafin akademik.			
Konkluzione	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e FSHMT, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UMT/FSHMT. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (NJSBC, GVB), por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, stafin akademik Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se FSHMT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. (Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni) Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë

	- Evidenca 3 Organigrama UMT - Evidenca 107 Manuali i karrierës së studentëve FSHMT - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me studentët, stafin akademik, Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në konferenca shkencore, aktivitete të ndryshme shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, stafin akademik Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se Sekretaria Mësimore, Zyra e Alumni dhe Karrierës, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë në shërbim dhe në funksion të studentëve. Evidenca: - Evidenca 107 Manuali i karrierës së studentëve FSHMT - Evidenca 110 Analizë vjetore zyra e financës - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mësimore shkencore në UMT - Evidenca E.1 Punim shkencor Pedagog, student 1. - Evidenca E.2 Punim Shkencor Pedagog, student 2. - Takimi me studentët stafin akademik, Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se UMT/FSHMT, zyra e Karrierës dhe Alumnit, ju ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor,

informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. <i>Nga takimi me studentët dhe stafin akademik u evidentua se një pjesë e vetë stafit akademik i kanë punësuar ish studentët e tyre apo i kanë referuar tek kolegët e tyre për punësim në klinikat private.</i> Evidenca: - Evidenca 107 Manuali i karrierës së studentëve FSHMT - Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës - Evidenca 120 Të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale - Takimi me studentet, stafin akademik, Zyra e Karrierës
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Po ashtu Urdhërat profesionale japin informacion mbi numrin e të punësuarve. Ky informacion disponohet pranë UMT per periudhën 2017-2021. Respektivisht për vitin 2017 ushtrojnë profesionin e mamisë 115 vetë, për vitin 2018 - 86 vetë, për vitin 2019-81 vetë, për vitin 2020 - 56, për vitin 2021-30 vetë. Evidenca: - Evidenca 107 Manuali i karrierës së studentëve FSHMT - Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës - Evidenca 120 Të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale - Evidenca RVB MP MAMI_i firmosur - Takimi me studentët Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës
Konkluzione	UMT/FSHMT ka procedura dhe njësi të posacme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë struktura të posacme si (Zyra e Këshillimit të

	<i>Karrierës dhe ALUMNI, Sekretaria mësimore, Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e IT). Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve Zyrën e Këshillimit të Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Zyra e Këshillimit të Karrierës asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Këto të dhëna u vihen në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar dhe FSHMT-së dhe Departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, UMT/FSHMT, e ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. UMT/FSHMT organizon trajnime për personelin akademik në lidhje me mësimdhënien në mënyrë që të realizohen metoda të ndryshme dhe inovative për mësimdhënien. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se

	Zyra e Kërkimit Shkencor ka marrë ekspertë nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve. Paralelisht, u dërgojnë thirrje për aplikime të ndryshme si dhe ëbsite. Përfaqësuesit e Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave raportuan se organizojnë aktivitete trajnuese, por jo në fushën e didaktikës ndërsa përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin raportuan se përmirësimi i mësimdhënies zhvillohet përmes aktiviteteve trajnuese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi në institucion GVJ konstaton se FSHMT harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve, duke u trajnuar nga NJSBC për hartimin e kurrikulave si dhe për sigurimin të cilësisë. Evidenca: - Evidenca 69 Përbërja e NJSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020 - Evidenca 91 Plani mësimor MP Mami - Evidenca 170 Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024 - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT - Evidenca E 5.1 Trajnim stafi FSHMT lidhur me hartimin e kurrikulave - Evidenca E 5.2 Përmbledhje takimi HAP_staf pedagogjik_Master Inf familje - Evidenca E 5.3 Lista e aktiviteteve në kuadër të sigurimit të cilësisë (përfshirë trajnimet) - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë FSHMT mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga UMT/FSHMT, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. FSHMT zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerëson në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të


	personelit akademik dhe ndihmës akademik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ vërejtë se kontakti dhe monitorimi i vijueshmërisë së procesit mësimor nga përgjegjësi i departamentit, pyetësorët e studentëve, formularët e performances akademike janë mekanizma që identifikojë në vazhdimësi cilësinë e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithshme informohen për rezultatet. Evidenca: - Evidenca 27 Pyetësi i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet_pyetesorit_studentet_23 - Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit_formular - Evidenca 68 Shembull_Pyetesor_Vlerësim i studenteve per UMT_formular - Evidenca 69 Përbërja e NjSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020 - Evidenca 145 Relacion cleanscore. - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstaton se FSHMT garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies (pyetësi për studentët), të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Studentët shprehën se ata kanë marrë pjesë në pyetësorë (on line) ku janë shprehur lirshëm dhe në mënyrë anonime lidhur me mësimdhënien për pedagogët dhe lëndët e programit të studimit. Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët, njëri për lëndën dhe tjeri për institucionin. Kjo është një procedurë standarde që UMT përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. Studentët shprehën se janë pjesë e NjSBC, GVB dhe RVB.
	Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të

	kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, neni 87 i Regullores së Njesisë kryesore. Ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 25 orëve nga shpallja e rezultateve, neni 92 i Regullores së Njesisë kryesore. Stafi akademik dhe Studentët raportuan se janë në dijeni se ka procedurë për kontestimin të një note, në rast se studenti nuk është dakord. Evidenca: - Evidenca 27 Pyetësi i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet_pyetesorit_studentet_23 - Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit_formular - Evidenca 68 Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular - Evidenca 69 Përbërja e NjSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020 - Evidenca 102 Urdher per ngritjen e GVB - Evidenca 145 Relacion cleanscore. - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Evidenca RVB Mami - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie GVJ konstaton se njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili përmban edhe plan masa për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. Në institucion, herë pas here lind nevoja e ngritjes së grupit të auditimit për problematika të ndryshme në monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit. Në çdo situatë të tillë grupi auditues harton një raport i cili i përcillet titullarit të institucionit. Evidenca: - Evidenca 14 Shembull_formulari i performancës 2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP

	- Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit - Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT - Evidenca 155 Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ - Evidenca 156 Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - E.7 Praktikë e auditit të brendshëm në FSHMT - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UMT/FSHMT në kuadër të planit të përgjithshëm strategjik rëndësi dhe vend të veçantë i kushton cilësisë së procesit mësimor si edhe të gjitha shërbimeve mbështetëse për realizimin e këtij procesi. I gjithë stafi akademik është i informuar, merr pjesë dhe dëshmon angazhim maksimal në proceset e sigurimit të cilësisë akademike. GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti-Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore). Nga takimi me përfaqësues të Drejtorisë së kërkimit, promovimit akademik dhe komunikimit dhe me drejtuesit e FSHMT, u informuam se në mbështetje të personelit akademik, FSHMT miraton cdo vit akademik ka një fond të vecantë për kërkimin shkencor (botime, konferenca etj) Evidenca: - Evidenca 10 Revista shkencore FSHMT 2022,2023 - Evidenca 15 Aktivitete libri i abstrakteve knonferenca e shkencave mjekesore - Evidenca 18 Konferenca vjetore libri i abstrakteve FSHMT - Evidenca 19 Aktiviteti dt 14 Nentor 2023 në FSHMT

	- Evidenca 29 Programi konferenca VLORE 2023 - Evidenca 30 Konferenca vjetore 2023 FSHMT ne bashkepunim me UV dhe UISH - Evidenca 70 Lista e publikimeve_Keshilli i botimeve 2022-2023 - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 97.2 Tabela permbledhes Ascal - Evidenca 152 Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT - Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit - Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT - Evidenca 155 Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ - Evidenca 156 Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike - Evidenca 167 Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore UMT - Evidenca E 5.1 Trajnim stafi FSHMT lidhur me hartimin e kurrikulave - Evidenca E 5.3 Lista e aktiviteteve në kuadër të sigurimit të cilësisë (përfshirë trajnimet). - Evidenca E 7.1 Kërkesë për rimbursim Etleva Rustami - Evidenca E 7.2 Rimbursim miratuar E. Rustami - Evidenca E 7.3 Kërkesë për rimbursim Ledio Necaj - Evidenca E 7.4 Rimbursim miratuar L. Necaj - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
--	---

Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posatëshme periodikisht programet e studimit. Ky sektor në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore zhvillon në fund të çdo semestri pyetësorët studenteve për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies. Sistemi i sigurimit të cilësisë funksion në rang institucional dhe ka njësi të veçanta në çdo njësi kryesore. GVJ konstaton se të dhënat në raportin përfundimtar janë kryesisht përshkruese në terma sasiorë dhe analitike si dhe evidentohet adresim i problematikave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015 dhe Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018), institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UMT dhe në rregulloren e FSHMT. Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 3 Organigrama UMT - Evidenca 5 Rregullore-FSHMT - Evidenca 27 Pyetësori i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet pyetësorit studentet 23

	- Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit formular - Evidenca 68 Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular - Evidenca 69 Përbërja e NjSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020 - Evidenca 102 Urdher për ngritjen e GVB - Evidenca 145 Relacion cleanscore. - Evidenca 100 Rregullore për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet, Organet Drejtuese, Komisionet - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - E.7 Praktikë e auditit të brendshëm në FSHMT - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se FSHMT ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë duke përfshirë dhe studentët si pjesë e NjSBC, GVB. GVJ konsaton se NjSBC e UMT ku FSHMT është pjesë e saj, siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit dhe ka hartuar një Plan Strategjik të Zhvillimit të UMT-së për periudhën 2021-2024 dhe një plan veprimi për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë për periudhën 2021-2023. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 21 Rregullore për Programi MP Mami në FSHMT - Evidenca 69 Përberja e NjSBC - VSA nr.103, dt.20.10.2020 Per miratimin e NJSBC ne UMT - Evidenca 76 Plan veprimi 2021-2023 per Rritjen e Cilesise se Arsimit te Larte - Evidenca 170 Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-te-UMT-se-2021-2024 - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e	Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm duke përdorur instrumente matëse dhe vlerësuese për vlerësimin periodik të

duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	programeve të studimeve dhe i ka përfshirë informacionet e nevojshme në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilësisë. Në përputhje me detyrimet ligjore për vlerësimin e jashtë të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit, UMT i është nënshtruar përiodikisht akreditimeve me ekspertë vendas dhe të huaj të aprovuara nga ASCAL. Të gjitha vlerësimet janë konsideruar si një hap për përmirësime të mëtejshme dhe janë respektuar e plotësuar në kohë gjithmonë rekomandimet e grupeve audituese. Bazuar në konstatimet dhe detyrat që dalin nga kontrollet dhe mënyrat e tjera të verifikimit të fakteve NJSBC harton raporte periodike si dhe një raport vjetor i cili është transparent dhe bëhet i njohur për stafin, studentët dhe për të tretët Kështu nga shqyrtimi i dokumnetacionit GVI konstatoi se nga Vendimi nr.3, date 27.01.2023 i Bordit të Akreditimit, ASCAL rezultoi se UMT është akredituar pozitivisht për 6 vite me afat përfundimtar me datë 26.01.2029. Ndërkohë programi i studimit MP në Mami është në proces akreditimi. Evidenca: - Evidenca 27 Pyetësori i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 169 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional _UMTmaj 2022 - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT - Raport i NJSBC - E.7 Praktikë e auditit të brendshëm në FSHMT. - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet	Institucioni ka një hierarki funksionimi dhe mbikqyrje që mban nën kontroll të vazhdueshëm zbatimin me rigozitet të rregulloreve. Dekani, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i programit, përfaqësuesi i NJSBC në Fakultet koordinon dhe mbikqyrin vazhdimisht zbatimin e programit mësimor. Institucioni organizon

rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	audite të brendëshme të drejtuar nga NJSBC për dokumentacionin e çdo programi dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Evidenca: - Evidenca 14 Shembull formulari i performancës 2023 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021 DLKIPISBP - Evidenca 155 Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrative - E.7 Praktikë e auditit të brendshëm në FSHMT - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.			
Konkluzione	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UMT dhe në rregulloren e institucionit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit dhe funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete bazuar në rregulloren NJSBC.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

122

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe takimi në institucion GVI konstaton se të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC, i cili i vihet në dispozicion rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili shërben si një historik për performancën institucionale. Ky raport i përvitshëm dërgohet konform legjislacionit edhe në MAS. Institucioni prej kohësh ka bashkëpunim me aktorë të jashtëm për të vlerësuar performancën e stafit akademik dhe administrativ dhe institucionit në përgjithësi. Një rol të rëndësishëm në auditimin e institucionit sidomos në plotësimin e standardeve të stafit akademik dhe infrastrukturës luan edhe kontrolli i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për plotësimin e standardeve të mësipërme. Në përfundim të këtij kontrolli ky grup harton një raport që më pas i dërgohet institucionit dhe shërben si një udhërrëfyes i rëndësishëm sidomos për vitin pasardhës akademik. Evidenca: - <i>Evidenca 11 Praktikë për miratimit e planeve mësimore</i> - <i>Evidenca 11.1 Praktikë për propozim ndryshimesh në planet mësimore viti akademik 22-23</i> - <i>Evidenca 14 Shembull formulari i performancës 2023</i> - <i>Evidenca 56 Procedura, afatet dhe dok. për hapjen e programeve të reja, riorganizimin dhe miratimin periodik të planeve</i> - <i>Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021</i> - <i>Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022</i> - <i>Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023</i> - <i>Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023</i> - <i>Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP</i> - <i>Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP</i> - <i>Evidenca 155 Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrative</i>
---	---

	- <i>Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi se në raportin vjetor të NJSBC përfshihen rezultatet e pyetësorëve që shoqëruar me grafik për çdo pyetje të drejtuar stafit ose studentëve duke vlerësuar përqindjet e çdo alternative për përgjigjet si dhe duke komentuar rezultatet. Në fund të paraqitjes së rezultateve të pyetësorëve bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e korrigjimit apo përmirësimit dhe rekomandohen plan masash me synim rritjen e cilësisë akademike. Të gjitha këto të dhëna paraqiten të detajuara në raportet vjetore dhe analizat vjetore periodike (për aktivitetin akademik e shkencor) në nivel të FSHMT dhe UMT. Evidenca: - <i>Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> - <i>Evidenca 27 Pyetësori i studenteve në FSHMT 23</i> - <i>Evidenca 28 Rezultatet e pyetësorit të studenteve 2023</i> - <i>Evidenca 76 Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë</i> - <i>Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21</i> - <i>Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22</i> - <i>Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021</i> - <i>Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022</i> - <i>Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023</i> - <i>Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023</i> - <i>Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP</i> - <i>Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP</i> - <i>Evidenca E 2.1 Plan masash për zhvillimin e procesit mësimor 20-21.</i> - <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Metodat e përdorura nga UMT për vlerësimin dhe realizimin me efektivitet të procesit mësimor janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.

studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Stafi akademik dhe Administrativ i Universitetit, fton studentët në diskutime të hapura, dhe ju mundëson atyre shprehjen e lirë të gjitha çështjeve që lidhen me procesin arsimor.

Vlerësimi i studentëve bëhet në format e përcaktuara ligjore të cilat janë inkorporuar në Statutin, Rregulloren e përgjithshme dhe në programet e veçanta të studimit.

Për vlerësimin e studentëve përdoren të gjitha format e vlerësimit përfshirë këtu testimet, seminarët, detyra kursi, projektet, prezantime, sipas lëndëve specifike dhe nga pedagogu i lëndës i cili mban shënime të veta për vlerësimet gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar. Këtë e referojnë studentët dhe pedagogët gjatë bashkëbisedimit në takimin në institucion.

Të gjithë studentët gjatë kryerjes së praktikave të tyre mbikqyren nga infermierët mbikqyrës nga të cilët kërkohet vazhdimisht opinion në lidhje me frekuentimin, paraqitjen dhe cilësinë e punë së studentëve në ambientin klinik. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u konstatua se ky dokumentacion iu vihet në dispozicion stafit akademik para provimit të praktikës nga mbikëqyrësit, dokumentuar dhe tek ditari i praktikës profesionale.

Gjithashtu institucioni merr vazhdimish informacion nga autoritete si UISH për rezultatet e arritura nga provimi i VAP (Vlerësimi i arritjeve praktike) dhe provimi teorik nga QSHA për licensimin e studentëve. Ky informacion disponohet në formë shkresore nga UMT dërguar nga Urdhërat profesionale (UISH) si të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale.

Evidenca:

- *Evidenca 11 Praktikë për miratimit e planeve mësimore*
- *Evidenca 11.1 Praktikë për propozim ndryshimesh në planet mësimore viti akademik 22-23*
- *Evidenca 13.1 Shembull Ditar praktike Infermieri-Mami*
- *Evidenca 13.2 Shembull Ditar praktike Mami 2*
- *Evidenca 13.3 Shembull Ditar praktike Mami 3*
- *Evidenca 27 Pyetësi i studenteve ne FSHMT 23*
- *Evidenca 28 Rezultatet e pyetësorit te studenteve 2023*
- *Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21*
- *Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22*
- *Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021*




	- Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 83 Analizë vjetore DLKIPISBP viti akademik 2022-2023 - Evidenca 84 Analizë vjetore 2022 DLKIPISBP - Evidenca 85 Analizë vjetore viti akademik 2021, DLKIPISBP - Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës - Evidenca 120 Të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale - Evidenca 164 Rregullore e sekretarisë mësimore - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Evidenca E 5.1 Trajnim stafi FSHMT lidhur me hartimin e kurrikulave. - Evidenca E 5.2 Përmbledhje takimi HAP_staf pedagogjik_Master Inf familje. - Evidenca E 5.3 Lista e aktiviteteve në kuadër të sigurimit të cilësisë (përfshirë trajnimet). - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e	GVJ konstaton se FSHMT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor Metodën e tërthorta: Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, ku ata mund të shprehen në kushte anonimiteti për të gjitha këto procese (Pyetësi i studentëve në FSHMT 23, Pyetësi i Vlerësimit I studentëve për lëndët e programit të studimit, Pyetësi i Vlerësimit të studentëve për UMT, sondazhi kombëtar i studentëve i organizuar nga ASCAL në 2022). Stafit mësimdhënës i kërkohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik raporte mbi problematikat e hasura gjatë procesit akademik, gjithashtu një feedback merret edhe nga mbikqyrësit e praktikave në lidhje me mirëfunksionimin dhe angazhimin e studentëve në shërbimet spitalore. Institucioni informohet në mënyrë periodike për rezultatet e studentëve në provimin e licencës nga UISH. Evidenca:

dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	- Evidenca 27 Pyetësi i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023 - Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit_formular - Evidenca 68 Shembull_Pyetësor_Vlerësim i studentëve për UMT_formular - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës - Evidenca 120 Të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale - Evidenca 156 Formular Vlerësimi i veprimtarisë akademike - Evidenca 155 Shembull_Vlerësimi i performancës së stafit administrativ - Evidenca 145 Relacion cleanscore - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.			
Konkluzione	UMT përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetësorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultatet e proceseve të anketimit të studentëve paraqiten në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC. Një formë tjetër është edhe raporti nga UISH, gjë për të cilën GVJ sugjeron që FSHMT në frymën e bashkëpunimit me urdhrin, të konsiderojë dhe rezultatet nga UISH, në funksion të rritjes së performancës së studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, në përbërje të NJSBC ka nga një anëtar nga çdo Fakultet i UMT-së (FSHMT), një ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues të unionit studentor. Megjithatë në funksion të procesit akademik ka një angazhim të shumëfishtë që përfshin personelin e pritjes, përgjegjësin e programit, sekretarinë mësimore si dhe drejtuesit e njësive bazë që janë në kontakte të vazhdueshme me studentët dhe stafin e çdo programi studimi. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 21 Rregullore_fshmt_Program cikli i dyte Master Profesional - Evidence 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca E 5.1 Trajnim stafi FSHMT lidhur me hartimin e kurrikulave. - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHMT, Përgjegjësit e Departamenteve, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkëpunues dhe të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë.

	Studentët u shprehën të kënaqur për programin e studimit që ndiqnin. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB. Evidenca: - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 21 Rregullore _fshmt_Program cikli i dyte Master Profesional - Evidence 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 27 Pyetësori i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet e pyetesorit te studenteve 2023 - Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit _formular - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 102 Urdher per ngritjen e GVB - Evidenca 145 Relacion cleanscore - Evidenca 169 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional _UMTmaj 2022 - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Ne vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit “Master profesional në Mami”, njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave në mënyrë transparente, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, sic është personelit akademik, ndihmes akademik e administrativ. GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, me drejtues, stafin akademik, studentët konstaton dhe mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit

Handwritten signature

Handwritten signature

	administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit. Studentët raportuan se ata pyetishin nga pedagogët për mundësi përmirësimi të programit të lëndëve por nuk kishin marrë pjesë në procedurë për përmirësimin e programit të studimit. Evidenca: - Evidenca 27 Pyetësori i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023 - Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit_formular - Evidenca 79 Raport vjetor UMT 2020-21 - Evidenca 79.1 Raport vjetor UMT 2021-22 - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 87 Shembull njoftim mbledhje departamenti vendimmarrje - Evidenca 87 Shembull mbledhje departamenti vendimmarrje - Evidenca 145 Relacion cleanscore - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstatoi se lidhur me përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 27 Pyetësori i studentëve në FSHMT 23

	- Evidenca 28 Rezultatet e pyetesorit te studenteve 2023 - Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit_formular - Evidenca 145 Relacion cleanscore - Evidenca 71 Përbërja e Këshillit të Etikës - Evidenca 72 Kodi i Etikës-UMT - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT. - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës, GVJ konstatoi se pjesë aktive e procesit të vlerësimit shpesh janë dhe përfaqësues të institucioneve të bashkëpunimit të cilët japin sugjerime në lidhje me organizimin e procesit mësimor, përmirësimin e literaturës, organizimin e orëve laboratorike dhe praktikave klinike. Vlerësimi i jashtëm i cili kordinohet nga ASCAL shërben për sigurimin e cilësisë së programit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet vlerësimit të RVB dhe më pas nga GVJ me anë të RVJ pasqyrohet gjëndja aktuale dhe jepen rekonandime me qëllim përmirësimin e standarteve të cilësisë. Gjithashtu rregullorja e NJSBC parashikon përfshirjen e një eksperti të jashtëm në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Fakt është se nëpërmjet takimeve pune, në ambjentet e qendrave spitalore universitare ku dhe studentët kryejnë praktikën, këta ekspertë të fushës japin kontributin e tyre. Vlen të theksohet se UISH nëpërmjet informacionit mbi liçensimin dhe punësimin e studentëve të diplomuar bashkëpunon si ekspert i jashtëm me FSHMT. Evidenca: - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 21 Rregullore_fshmt_Program cikli i dyte Master Profesional - Evidence 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 50 Praktika e ndjekur per auditim nga njesi audituese e jashtme (UNICEF)

Handwritten signature

Handwritten signature

	- Evidenca 51 Praktika e ndjekur per auditim nga Njesia e Auditit te Brendshem - Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës - Evidenca 120 Të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.			
Konkluzione	Bazuar në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 2020-2024 të UMT/FSHMT, është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit. Prania e studenteve si anëtare të komisionit krijon mundësinë e bashkëveprimit me studentët me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Rregullorja e NJSBC parashikon përfshirjen e eksperte te jashtem në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, dhe faktisht nuk kemi pjesëmarrje të tyre. NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjithë UMT/FSHMT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstatoi se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj. gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. Evidenca:

	- ëëë.umed.edu.al - Evidenca 1 Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë - Evidenca 2 Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë - Evidenca 5 Rregullore FSHMT - Evidenca 21 Rregullore <i>fshmt</i>_Program cikli i dyte Master Profesional - Evidenca 21.1 Rregullore MP Mami - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstatoi se NJSCB realizon pyetësorët institucional në fund të çdo semestri në mënyrë elektronike, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Në hartimin e raportit NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 9887/10.03.2008 ndryshuar me ligjin 48/2012). Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve. FSHMT publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet ëëb për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar. Evidenca: - ëëë.fshmt.edu.al - Evidenca 27 Pyetësori i studentëve në FSHMT 23 - Evidenca 28 Rezultatet e pyetësorit të studenteve 2023 - Evidenca 67 Shembull Pyetësor_Vlerësim I studentëve për lëndët e programit të studimit_formular - Evidenca 145 Relacion cleanscore - Evidenca 72 Kodi i Etikës-UMT - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik. Ky raport

masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkret. Në përgjithësi, pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat repsektive, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna. Evidenca: - Evidenca 76 Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë - Evidenca 80 Raport vjetor FSHMT 2020-2021 - Evidenca 81 Raport vjetor FSHMT 2021-2022 - Evidenca 82 Raport vjetor FSHMT 2022-2023 - Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se UMT për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatin Akademik të UMT për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohen dhe një raport vjetor. Në këtë raport shqyrtohen problematikat dhe veprimet që duhen të ndërmerren për të siguruar përmirësimin. GVJ konstaton se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Evidenca: - Evidenca 79.1 Raporti Vjetor_UMT_2021-2022. - Evidenca E 5.1 Trajnim stafi FSHMT lidhur me hartimin e kurrikulave. - Evidenca E 5.2 Përmbledhje takimi HAP_staf pedagogjik_Master Inf familje. - Evidenca E 5.3 Lista e aktiviteteve në kuadër të sigurimit të cilësisë (përfshirë trajnimet). - Evidenca E 7 Praktikë e auditit të brendshëm në FSHMT - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UMT për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit organizon veprimtari të parashikuara në Plan veprimin për Rritjen e Cilesise se Arsimit të Lartë dhe bën analizë në rang institucioni, dekanati, departamenti dhe kjo është një pikë e fortë e institucionit. Përfaqësuesi i NJSBC, stafi akademik si dhe përgjegjësit e programeve luajnë rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin për sigurimin e cilësisë në programin mësimor. GVJ konstaton se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët me qëllim informimin, asistencën dhe trajnimin për një pjesëmarrje aktive dhe efektive në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke i informuar dhe ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Evidenca: - Evidenca 76 Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë - Evidenca 79.1 Raporti Vjetor _UMT_ 2021-2022 - Evidenca 82 Raporti vjetor FSHMT 2023 - Evidenca 85. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2021 - Evidenca 154 Analize për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT - Evidenca 169 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional _UMT_maj 2022; - Evidence 180 Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT - Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Konkluzione	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera nga UMT/FSHMT janë raporte përshkruese dhe analitike. Këto raporte shoqërohen me plane masash dhe adresimin e problematikave të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ rekomandon marrjen në konsideratë të raportit të UISH, në mënyrë që të rritet performanca e studentëve.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

136

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Profesional në “Mami” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”.

Pika të forta dhe afirmime:

1. Infrastruktura dhe ambjentet e mjaftueshme për mësimdhënien si dhe fakti që godina e FSHMT është brenda QSUT, ndihmon studentët në praktikën profesionale.
2. Mundësia për të realizuar praktikat profesionale në mjedise interaktive, dinamike pranë konsultoreve apo Qëndrave Universitare Spitalore “Koco Gliozheni” dhe “Mbretëresha Geraldinë”, QSUT etj.
3. Pothuaj i gjithë personeli akademik i UMT/FSHMT është me tituj/grada akademike.
4. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik u evidentua se një pjesë e vetë stafit akademik i kanë punësuar ish studentët e tyre apo i kanë referuar tek kolegët e tyre për punësim në klinikat private.

Pika të dobëta:

Rekomandime:

1. Të nxitet promovimi i këtij programi, duke e bërë më atraktive për vitin akademik të ardhshëm të rihapet ky program.
2. Të unifikohet struktura dhe të rifreskohet i literatura në sillabuset e lëndëve.
3. GVJ sugjeron që nga sektori përkatës të shihet mundësia e unifikimit të formatit të CV të stafit akademik.
4. Të përfshihet një ekspert i jashtëm në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit.

Conclusions of the evaluation of the study program of the second cycle Master of Professional in “Midwifery” offered by the Institution of Higher Education “University of Medicine, Tirana”.

Strengths and Affirmations:

1. Sufficient infrastructure and facilities for teaching, as well as the fact that the FSHMT building is within QSUT, helps students in their professional practice.
2. The opportunity to carry out professional practices in interactive, dynamic environments near the consultancies or University Hospital Centers “Koco Gliozheni” and “Queen Geraldine”, QSUT, etc.
3. Almost all the academic staff of UMT/FSHMT is with academic titles/ranks.
4. From the meeting with the students and the academic staff, it was evident that some of the academic staff employed their former students or referred them to their colleagues for employment in private clinics.

Weaknesses:**Recomandation:**

1. Promote the promotion of this program, making it more attractive for the next academic year.
2. To unify the structure and refresh the literature in the course syllabuses.
3. GVJ suggests that the relevant sector consider the possibility of unifying the CV format of the academic staff.
4. To include an external expert in the internal evaluation process of the study programs.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

